

SILVANA NINI

LIBËR PËR MËSUESIN
Arti pamor 6

BOTIME



Përmbajtja

1. Hyrje

1.1	Pse shërben ky libër?	4
1.2	Çfarë synon ky libër?	5
1.3	Çfarë përmban ky libër?	5

2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre

2.1	Lidhja e artit pamor me <i>kompetencat kyçe</i>	6
2.2	Lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare	8
2.3	Kuptimi i <i>kompetencave</i> lëndore të <i>artit pamor, i tematikave</i> dhe lidhja ndërmjet tyre	12

3. Planifikimi i kurrikulës – kuptimi dhe zbatimi

3.1	Plani vjetor i lëndës “Art pamor”, sipas tremujorëve	14
3.2	Plani vjetor tematik	20

4. Metodologjia e Mësimdhënies

4.1	Metodologjia e të nxënit dhe mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor	31
4.2	Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit	33
4.3	Materiale dhe burime mësimore	104

5. Vlerësimi

5.1	Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar	106
-----	--	-----

1. HYRJE

Arti pamor ka të bëjë me materializimin e mendimit, ashtu si edhe me shprehjen e një realiteti social-kulturor. Që në fillimet e veta, njerëzimi e ka përdorur artin pamor si një mënyrë për të përcjellë nëpërmjet imazhit botëkuptimin e tij, duke përdorur aftësi që ndryshojnë në varësi të vendit, periudhës historike dhe kulturës. Mënyra se si na e përshkruan historia e artit praninë e imazheve artistike përgjatë shekujve, që nga parahistoria (përpara shfaqjes së shkrimit), na tregon për rëndësinë që kishin njohuritë artistike për njeriun. Këto njohuri dhe aftësi artistike kanë zënë rrënjë në ndjeshmërinë, intuitën dhe imagjinatën e tij. Artistët/et kanë kontribuar në zhvillimin e ideve dhe si rrjedhojë edhe të shoqërisë duke shprehur bindjet, vlerat dhe shqetësimet përmes veprave të tyre të artit.

Në artin pamor imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve e të materialeve dhe teknikave të ndryshme artistike që përdoren për ta realizuar atë. Ai mund të jetë dy ose tridimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik etj. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës pamore së një vepre varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë.

Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit/es dhe pasuron kulturën e tij/saj. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit/et të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot në kulturën e edukimit i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit, dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social dhe artistik të nxënësve/eve.

Duke u mbështetur në kërkesat e programit, libri i artit pamor i klasës së gjashtë, bazohet në tre kompetenca: krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit.

Krijimtaria në art, kontribuon në formimin e identitetit personal, të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore e të ndjeshmërisë artistike. Nxënësit/et kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën pamore, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar.

1.1 Pse shërben ky libër?

Ky libër do t' u shërbejë mësuesve/eve të artit pamor, të njohin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në këtë lëndë, për zbatimin më së miri të risive në kurrikulën e artit pamor.

1.2 Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimit po zbaton mësimdhënien bazuar në **kompetenca**, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e artit pamor, të cilët/at do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arteve, programi mësimor*, dhe vlerësimi bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në arte*, të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

- a) planifikimin e të nxënimit;
- b) metodologjinë e mësimdhënies;
- c) vlerësimin e të nxënimit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është t'i orientojë dhe t'i ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e gjashtë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së artit pamor, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kyçe tek nxënësit/et e klasës së gjashtë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare e me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

1.3 Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së gjashtë, të shkallës së tretë të lëndës “Arti pamor”, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014.

Meqenëse jemi në hapat e parë të kësaj reforme me qasjen e re bazuar në kompetenca, ky libër merr përsipër:

- të sqarojë çdo mësues/e të artit pamor për të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatohet çdo mësues/e në lëndën e tij;
- të prezantojë dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e artit pamor;
- të udhëzojë për të gjitha formatet e reja: planin vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënimit, formatet e vlerësimit etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënimit, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

2. KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Kjo çështje ka si qëllim kuptimin:

për krijimin e kushteve për ndërtimin e *kompetencave të lëndës* së *artit pamor* si dhe të *kompetencave kyçe*, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën;

për realizimin e *temave ndërkurrikulare* nëpërmjet lëndës së artit pamor, i cili është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i programit të artit pamor;

për kontributin e artit pamor në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

Në këtë modul, gjithashtu, përshkruhet *lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare*, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të formimit të nxënësve/eve.

Arti pamor zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë *arsimin fillor* (AF) klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët* (AMU) klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre 9-të vite shkollimi.

Të katërta shkallët grupohen në mënyrë të tillë:

- *shkalla e parë*: klasa përgatitore (mosha parashkollore 5-6 vjeçare) – klasa dytë;
- *shkalla dytë*: klasa e tretë – klasa e pestë;
- *shkalla e tretë*: klasa e gjashtë – klasa e shtatë;
- *shkalla e katër*: klasa e shtatë – klasa e tetë.

2.1 Kompetencat kyçe dhe arti pamor

Fjala *kompetencë* ka filluar të lakohet rëndom në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave që i aftësojnë individët /nxënësit/et të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
2. Kompetenca e të menduarit.
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.
5. Kompetenca personale.
6. Kompetenca qytetare.
7. Kompetenca digjitale.

Kompetencat kyçe, në artin pamor zhvillohen sipas një konteksti të caktuar artistik. Në shkallën e tretë në programin mësimor të artit pamor, ato vijnë të ndërtuara nga dy shkallët paraardhëse. Programi i artit pamor ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to.

Tabela: ¹ Rezultatet kryesore të të nxënësve sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor për shkallën e tretë

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. krijon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike; 2. kupton drejt mesazhet, që u adresohet; 3. shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale; 4. është komunikues efektiv; 5. orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.
Kompetenca e të menduarit
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; 2. zgjidh probleme të ndryshme artistike; 3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; 4. ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik; 2. përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim; 3. zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ndërmer nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; 2. kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
Kompetenca personale
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; 2. përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet; 3. rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit të tjerët.
Kompetenca qytetare
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; 2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve; 3. bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

1 Kjo tabelë është marrë nga programi mësimor i artit pamor, klasa e gjashtë.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetete informuese në internet;
2. njeh dhe përdor mjetet audio, video Cd, Dvd, aparat fotografik dixhital, kamera, etj.

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë **7 kompetencat kyçe**, dhe si t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et, sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohen dhe arrihen përgjatë një shkalle të caktuar. **Kompetencat kyçe** të shkallës së tretë lidhen me klasën e gjashtë dhe të shtatë, të AMU-s. Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç kompetencave lëndore të artit pamor të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit/et e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

2.2 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e Artit pamor

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënësve që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët, i cili zhvillohet dhe ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe: **krijimit, performimit/realizimit dhe vlerësimit**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **kompetencat specifike lëndore të artit pamor brenda** fushës së arteve. Kompetencat lëndore të artit pamor lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së artit pamor dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

Zotërimi i artit pamor nënkupton **zotërimin e kompetencave pamore**, që do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar e përdorur artin pamor në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata, në të cilat ky art luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm. Me kurrikulën e re, arti pamor është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat listohen si më poshtë:

Kompetenca 1: Krijimi artistik, ka të bëjë:

- me përdorimin e ideve dhe organizimin gjuhës pamore në një krijim artistik;
- me përdorimin e mjeteve dhe teknikave artistike për realizimin e ideve nëpërmjet përdorimit të gjuhës pamore.;
- me vlerësimin e ideve krijuese dhe ndarjen e përvojave me të tjerët.

Kompetenca 2: Realizimi i punimit, ka të bëjë:

- me kuptimin dhe zbatimin e teknikave të larmishme artistike dy dhe tridimensionale, për realizimin e ideve krijuese nëpërmjet gjuhës pamore;

- me përdorimin e teknikave dhe të proceseve artistike dhe me ndarjen e përvojave me të tjerët.

Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave të artit, ka të bëjë:

- me kuptimin dhe analizimin e veprave artistike, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

Tabela² e kompetencave lëndore të artit pamor dhe përshkrimi i tyre

Kompetencat e artit pamor	Përshkrimi i kompetencave lëndore
Krijimi artistik	<p>Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përdor ide personale dhe stimuj për krijim; ▪ zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; ▪ përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; ▪ përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; ▪ përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; ▪ analizon qëllimin e tij/saj krijues; ▪ identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
Realizimi i punimit	<p>Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; ▪ krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; ▪ ndan eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit; ▪ zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; ▪ eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; ▪ analizon qëllimin e tij/saj krijues; ▪ identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
Vlerësimi i veprave të artit	<p>Nxënësi/ja</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; ▪ identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; ▪ identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; ▪ interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; ▪ përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tyre artistike;

Tematikat që përshkojnë lëndën e artit pamor


Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë *tri kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës/e duhet të zotërojë gjatë jetës

së tij/saj dhe që arrihen nëpërmjet *tri tematikave kryesore*.

Tematikat përmbajtësore, janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit, dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe të *kompetencave kyçe*. Për çdo tematikë janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të çdo shkalle përkatëse. Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe përshkrimi i **kompetencave lëndore** që duhet të demonstrojë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle.

TEMATIKAT E ARTIT PAMOR	KOMPETENCAT E ARTIT PAMOR
<p>Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik. Nxënësi/ja zbulon elementet e gjuhës pamore dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve. Përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike. Procesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit/es për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme. Personalizimi i temave e i subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues.</p>	<p>Kompetenca 1: Krijimi artistik.</p> <p>Kompetenca 2: Realizimi i punimit</p> <p>Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave të artit.</p>
<p>Tematika 2: Teknika dhe procese artistike. Nxënësi/ja krijon punë dy dhe tridimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike. Ai/ajo zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit. Një vend të rëndësishëm zë përzgjedhja e qëllimshme e teknikave artistike nga nxënësi/ja, eksperimentimi me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar. Gjithashtu, ai/ajo zhvillon aftësitë e tij/saj për të organizuar gjuhën pamore nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan përvojat krijuese me të tjerët/at.</p>	
<p>Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria. Nxënësi/ja analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social-kulturor. Ai/ajo komunikon emocionet dhe gjykimin e vet mbi vepra të ndryshme arti, mbi punën e tij dhe të shokut/shoqes. Duke iu referuar historisë së artit dhe të kulturës nxënësi/ja, pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi/ja kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe të artistit/es në shoqëri, dhe respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme.</p>	

Diagrama1:³ Kompetencat kyçe dhe lëndore, të cilat formohen përmes tematikave të artit pamor




Nëse do të bënim një shpjegim të diagramës, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së artit pamor, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi/ja. Mësuesi/ja duhet të ketë parasysh kompetencat lëndore dhe rezultatet që do të arrihen.

3 Kjo diagramë është marrë nga programi mësimor i artit pamor, klasa e gjashtë, shkalla e tretë.

2.3 Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare. Diagrama 2⁴

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të të nxënësve në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, lëvizja, forma, ngjyra etj. lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si me kërcimin, me muzikën, me teatrin, por edhe me matematikën, me gjuhën, me shkencat shoqërore. Nxënësit/et nxiten të bëhen të vetëdijshëm për një numër procesesh që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare, të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor mundësojnë që nxënësit/et të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu, mësuesit/et duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm.

Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njohurive:



4 Kjo diagramë është marrë nga programi mësimor i artit pamor, klasa e gjashtë, shkalla e tretë.

3. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es, e cila zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës dhe dokumentet* përkatëse. Planifikimi këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: liri, fleksibilitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

1. Plani vjetor i lëndës së artit pamor, sipas tremujorëve;
2. Plani vjetor tematik.

Planifikimi i planit vjetor dhe tremujor, bëhet sipas ndarjes së kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i artit pamor, program ky, i dhënë në tabelën e mëposhtme:

Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Shkalla e tretë				
Klasa e gjashtë	10	17	8	35 orë

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me tremujorë, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillimviti të ri shkollor. Pra kemi tashmë një term të ri *tremujor* dhe jo *semestër*.

Temat mësimore në lëndën e artit pamor janë renditur sipas programit, pra çdo tematikë njëra pas tjetrës. Njohuritë ndërthuren në mënyrë mjaft organike me njëra-tjetrën pasi të trija kompetencat pasqyrohen në secilën tematikë.

Më poshtë vijojnë tabelat:

- a) e planifikimit vjetor të tremujorëve,
- b) e planifikimit vjetor temë për temë.

Tremujorët në modelin e mëposhtëm i kemi ndarë, duke bërë një përlllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave (me pluset ose me minuset që çdo mësues/e i llogarit vetë).

3.1 Planifikimi vjetor i lëndës “Art pamor”, sipas tremujorëve

Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
1. Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	<p>Shenja dhe pika Eksperimenton me lloje të ndryshme shenjash: shenja grafike, shenja piktorike, shenja plastike, duke kuptuar rëndësinë e tyre komunikuese.</p> <p>Vija Cilësitë e linjës. Vija si mjet shprehës. – Përdor cilësitë e ndryshme të vijës për qëllime të caktuara në krijimet e veta; – Përdor mjete të ndryshme artistike si lapsi, stilolapsi, karboni, lapustila, rapitografi etj, për të krijuar emocione të caktuara nëpërmjet vizatimeve me vijën.</p> <p>Forma dydimensionale Forma natyrore, format gjeometrike – Identifikon që edhe format bazë gjeometrike gjenden edhe në natyrë; – Zhvillon format gjeometrike në një dekoracion; – Analizon format natyrore në veprat e artistëve Paul Klee dhe Vasilij Kandinskij.</p>		

Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
1. Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	<p>Ngjyrat Perceptimi i ngjyrës Ngjyrat primare, ngjyrat sekondare – Ngjyrat e ngrohta, ngjyrat e ftohta. – Kupton zbërthimin e dritës së bardhë në ngjyra, nëpërmjet prizmit; – Përdor bojëra me bazë ujin, transparente dhe opake, penelat e përshtatshëm për të krijuar me përzierjen e ngjyrave parësore, dytësore, të ngrohta dhe të ftohta.</p> <p>Tekstura Tekstura të ndryshme (natyrale dhe artificiale). – Identifikon shembuj të ndryshëm të teksturës në natyrë dhe i interpreton në krijim, mbi sipërfaqe dy dhe tridimensionale.</p> <p>Vëllimi Drita dhe hijja (hija e objektit dhe hijja e mbartur) – Paraqet në mënyrë realiste një objekt ose disa objekte në marrëdhënie midis tyre nëpërmjet dritëhijes mbi një sipërfaqe dy-dimensionale;</p>		

Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
1. Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	<p>Hapësira Llojet e hapësirës, planet. – Zhvillon perceptimin pamor të distancave dhe thellësisë; – Zbulon dhe paraqet në krijim raportet hapësinore midis objekteve: përpara/mbrapa, sipër/poshtë etj.</p> <p>Baraspesha Simetria dhe asimetria – Zbulon simetrinë në natyrë dhe në art dhe përdor aksin e simetrisë dhe simetrinë rrethore në krijimet e veta; – Zbulon që asimetria është e kundërta e simetrisë dhe kupton rëndësinë e përdorimit të asimetrisë në veprat e artit dhe në arkitekturë.</p>		
2. Teknikat dhe proceset (17 orë)	<p>Vizatimi <i>Teknikat grafike: vizatimi me laps, karbon.</i> – Eksperimenton dhe krijon me mjete dhe teknika të ndryshme artistike, duke u mbështetur në natyrë, në mjedis, në përvoja personale, në fantazinë për të komunikuar ide. – Krijon duke përdorur karakteristikat shprehëse të mjeteve të vizatimit si: shkallëzimet tonale të lapsit, të karbonit dhe ndihmën e gomës etj;</p>		

Shpërndarja e përmbajtjes tëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
2. Teknikat dhe proceset (17 orë)	<p>– Paraqet formën tridimensionale – mbi sipërfaqen dydimensionale.</p> <p>Piktura <i>Akuareli</i></p> <p>– Zbulon efektet e teknikës së akuarelit dhe i përdor në krijim;</p>	<p>Mozaiku</p> <p>– Zbulon karakteristikat e teknikës së mozaikut dhe i përdor në krijim;</p> <p>Stampimi</p> <p>Monotipi, stampa me reliev dhe gërryerje.</p> <p>– Përdor teknikën e monotipit për të stampuar mbi sipërfaqe me tekstura të ndryshme;</p> <p>– Krijon stampa me reliev dhe nëpërmjet gërjes dhe stampon mbi sipërfaqe me teksturë të ndryshme.</p> <p>Fotografia</p> <p>Imazhe fotografike, aparati fotografik.</p> <p>– Zbulon që imazhi fotografik ndryshon nga imazhi artistik i pikturës apo vizatimit dhe është mënyra kryesore e komunikimit pamor e këtij shekulli;</p> <p>– Përdor një aparat të thjeshtë fotografik për një qëllim të caktuar, duke kompozuar saktë.</p>	<p>Konstruksioni.</p> <p><i>Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme.</i></p> <p>– Përdor materialet e duhura nëpërmjet proceseve, si: prerja, dhënia formë, ngjitja dhe ndërtimi i një strukture (letra e kartona, tela të përkulshëm, drunj me nyje, unaza perdes, material copash të qepura dhe të mbushura, tapa shishesh, shishe plastike etj).</p>

Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
2. Teknikat dhe proceset (17 orë)		<p>Grafik-dizajni dhe prezantimi Projekt artistik.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kupton mënyrën se si zhvillohet një projekt artistik nëpërmjet shënimeve, skicave dhe kërkimeve pamore; – Përdor stile të thjeshta shkrimi, të shkëputura e të prera nga revista, gazeta, etj, dhe të ngjitura, për një qëllim të caktuar, duke organizuar hapësirën së bashku me një imazh fotografik. <p>Skulptura</p> <ul style="list-style-type: none"> – Modelimi me plastelinë, baltë, karta pesta. – Gdhendja mbi materiale të buta. – Modelon vazo ose një reliev të thjeshtë, duke përdorur materiale, si: plastelinë, carta pesta; – Gdhend figura të thjeshta, duke përdorur materiale të buta, si: sapun, bukë peshku. 	
3. Historia arti dhe shoqëria (8 orë)			<p>Histori arti</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore.)

Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave			
Tematikat	Shtator – Dhjetor 13 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill - Qershor 10 orë
3. Historia arti dhe shoqëria (8 orë)			<p>Përvoja artistike</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vizita në studiot e artistëve/eve, punishtet e artizanëve/eve të zonës. – Takime me artistë/e, dizajnë/e, artizanë/e, arkitektë/e etj. <p>Ekspozita dhe evente kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vizita në muzeume, (arkeologji, etnografi) galeri arti, qendra kulturore, parqe arkeologjike, objekte të trashëgimisë kulturore etj. – Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet.

3.2 Planifikimi vjetor tematik.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: krijon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike; kupton drejt mesazhet, që u adresohet; shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale; është komunikues efektiv; orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.

Kompetenca e të menduarit: merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; zgjidh probleme të ndryshme artistike; zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik; përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim; zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: ndërmer nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kompetenca personale: zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet; rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare: diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; respekton punën e vet dhe të të tjerëve; bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësi dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

Kompetenca digjitale: gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetete informuese në internet; njeh dhe përdor mjetet audio, video Cd, Dvd, aparat fotografik dixhital, kamera, etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Krijimi artistik: përdor ide personale dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme për të realizuar idetë artistike; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike; përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje artistike; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementët të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

Realizimi i punimit: zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet për realizim; merr në konsideratë target grupin të cilit i referohet me idetë e tij/saj; eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; analizon qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementët të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

Vlerësimi i veprave të artit: identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon veprat e artit në aspektin e tyre historik; identifikon aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër ose objekt artistik; identifikon elementët të eksperiencës së tij/saj artistike, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1		Perceptimi pamor, iluzionet optike	<p>Zbulojmë mjedisin që na rrethon nëpërmjet shqisave tona Nëpërmjet imazheve të shfaqura ose nëpërmjet objekteve të ndryshme nxënësit/et ftohen për të diskutuar rolin e shqisave në perceptimin e objekteve. Ata/ato diskutojnë për rëndësinë që ka shqisa e të parit në perceptimin e mjedisit që i rrethon.</p>	<p>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;</p> <p>Puna në grup dhe puna individuale;</p> <p>Hetimi dhe zbulimi;</p> <p>Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;</p> <p>Metoda integrale;</p> <p>Bashkëbisedim;</p> <p>Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;</p> <p>Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK.</p> <p>Projekte kurrikulare.</p>	<p>Vlerësim diagnostikues</p> <ul style="list-style-type: none"> • intervistë me një listë treguesish; • vetëvlerësim me listë kriteresh; <p>Vlerësim për të nxënë (vlerësim formule)</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimi i përgjigjeve me gojë; • vlerësimi i punës nëgrup; • vlerësim mes nxënësis/esh; • vlerësimi i aktivitetit gjatë debeteve në klasë; • vlerësimi i detyrave të shhtëpisë; • vetëvlerësim; • intervistë me një listë treguesish; • vëzhgim me një listë të plotë treguesish; • portofol; • prezantim me gojë ose me shkrim; • projekt kurrikular. 	<p>Teksti i artit pamor për klasën e VI;</p> <p>Materiale nga interneti;</p> <p>Ilustrime veprash arti;</p> <p>Ilustrime të imazheve nga natyra në përshatje me tema të caktuara;</p> <p>Fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore;</p> <p>Slajde/ materiale të krijuara nga mësuesit/et;</p> <p>Modele të detyrave nga nxënësit/et.</p>
2	Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	Shenja dhe pika	<p>Shenja dhe pika si shprehje e komunikimit artistik. Nxënësit/et zbulojnë se shenja është një shprehje e komunikimit dhe se të gjitha veprat e artit kanë shenjat e tyre karakteristike. Nëpërmjet vëzhgimit dhe përvojës së tyre ata/ato zbulojnë që pika është shenja më e vogël. Ata/ato zbulojnë se pika ofron mundësi të shumta për t'u shprehur.</p>			
3		Vija	<p>Zbulojmë llojet e vijave në natyrë për t'u shprehur nëpërmjet vijës. Vëzhgimi i fotove nga natyra i ndihmon nxënësit/et të zbulojnë llojet e vijave, si dhe larminë e tyre në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu. Duke zbuluar larminë e llojeve të vijave në natyrë, ambientin që i rrethon dhe mundësitë e shumta të përdorimit të vijës në krijim, nxënësit/et nxiten të krijojnë duke përdorur elementin e vijës në mënyrë origjinale.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
4		Tekstura	<p>Larmi teksturash natyrale dhe artificiale. Vëzhgimi i objekteve, në natyrë dhe nëpërmjet fotografive, i nxit nxënësit/et të diskutojnë mbi sipërfaqet e shumëllojshme. Ata/ato zbulojnë teksturën në natyrë dhe teksturën e krijuar nga njëri në objekte të ndryshme.</p>			
5	Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	Forma dydimensionale	<p>Zbulojnë format natyrale dhe gjeometrike në natyrë. Nxënësit/et rendisin format e njohura natyrale dhe gjeometrike. Fotografitë e ndryshme i ndihmojnë ata/ato të përshkruajnë këto forma. Nxënësit/et zbulojnë format gjeometrike në natyrë dhe i krahasojnë me format bazë gjeometrike.</p>			
6		Vëllimi	<p>Të zbulojnë vëllimin nëpërmjet dritës. Nxënësit/et zbulojnë se forma dhe vëllimi i objekteve bëhet i dukshëm për syrin tonë nëpërmjet burimit të dritës. Nxënësit/et zbulojnë që vëllimi i objekteve është i barabartë me dritë + hije. Nëpërmjet imazheve ata/ato vëzhgojnë që objekti në pjesën që nuk rrihet nga drita për bëhet nga hijja e vet dhe nga hijja e mbartur.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
7		Ngjyra	<p>Drita burim i ngjyrave në natyrë. Nxënësit/et identifikojnë ngjyrat e ylberit dhe dritën si burim të ngjyrave. Zbërthimi i rrezes së dritës në ngjyra të ylberit bën që nxënësit/et të kuptojnë procesin e krijimit të ylberit, por edhe të kuptojnë pse i shohim ngjyrat e objekteve. Nga njohuritë e mëparshme ata/ato dinë për ngjyrat e para dhe të dyta dhe e kanë të lehtë të kuptojnë përbërjen e ngjyrave të treta. Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta ata/ato i identifikojnë në fotografi të natyra.</p>			
8	Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	Hapësira	<p>Mënyrat e paraqitjes së hapësirës në pikturë ose vizatim. Nxënësit/et diskutojnë se çfarë kuptojnë me fjalën hapësirë në përgjithësi dhe si është ajo rreth tyre. Ata/ato tregojnë sesi orientohen në hapësirë në marrëdhënie me objektet e tjera. Fotografi të ndryshme i ndihmojnë ata/ato të lidhin</p>			
9		Baraspesha	<p>Baraspesha është simetrike dhe asimetrike. Duke i referuar njohurive të mëparshme nxënësit/et identifikojnë simetrinë dhe asimetrinë në natyrë dhe në objektet e ndërtuara nga njeriu. Ata/ato nxiten të përdorin simetrinë ose simetrinë rrethore në krijimet e tyre.</p>			

Nr:	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
10	Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	Ekspozita jonë	<p>Krijimet tona në ekspozitë. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë</p>			
11		Teknika e vizatimit	<p>Të krijojmë shkallëzimet tonale. Mësuesi/ja krijon një atmosferë ku nxënësit/et flasin për njohuritë e tyre mbi teknikën e vizatimit dhe njetet që ata/ato përdorin në këtë teknikë. Nxënësit/et marrin në dorë lapsa me cilësi të ndryshme dhe zbulojnë vetë dallimet midis tyre. Njëpërmjet këtyre lapsave ata/ato orientohen të krijojnë shkallëzimet tonale</p>			
12	Teknika dhe procese artistike (17 orë)	Peizazh në teknikën e vizatimit	<p>Krijojmë peizazhin duke përdorur shkallëzimet tonale. Nxënësit/et vëzhgojnë peizazhet fotografike dhe diskutojnë për mënyrën se si shfaqet hapësira në to. Peizazhet në vizatim i orientojnë ata/ato për mënyrën se si e shprehin artistët/et hapësirën nëpërmjet vizatimit. Ata/ato nxiten të krijojnë hapësirën në peizazhin e tyre me teknikën e vizatimit duke përdorur shkallëzimet tonale.</p>			
13		Teknika e akuarelit	<p>Momente të ndryshme të qjellit të krijuara me akuarele. Në klasë krijohet një situatë ku nxënësit/et diskutojnë për njohuritë e tyre mbi teknikën e akuarelit dhe mënyrën se si ata/ato e kanë përdorur. Mësuesi/ja shpjegon njohuritë e reja dhe demonstroi mënyrën e përdorimit të kësaj teknike. Nxënësit/et nxiten të krijojnë qjellin dhe retë në momente të ndryshme, duke përdorur karakteristikat e akuarelit.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
14		<p>Qielli me re me teknikën e akuarelit</p> <p>Peizazh në teknikën e akuarelit.</p>	<p>Përdorimi i teknikës së akuarelit për krijuar një peizazh.</p> <p>Nxënësit vëzhgojnë peizazhet e akuarelit. Ata/ato diskutojnë se kanë realizuar peizazhe me laps, lapustila, por edhe me akuarela. Ata/ato diskutojnë për mënyrën se si e përdorën akuarelin në mësimin e kaluar. Mësuesi/ja demonstroi radhën e punës dhe nxënësit/et fillojnë të krijojnë peizazhin sipas imagjinatës së tyre ose duke u mbështetur në modelet fotografike.</p>			
15	Teknika dhe procese artistike (17 orë)	Mozaiku me letër	<p>Krijojmë një kafshë nëpërmjet mozaikut me letër.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë për teknikën e mozaikut me letër. Për mënyrën e përdorimit të saj nga eksperinca e tyre. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të vëzhgojnë mozaikun romak, mënyrën e punimit dhe i orienton që, duke u nxitur nga kjo punë, të krijojnë një peshk sipas fantazisë së tyre ose një kafshe tjetër.</p>			
16		Mozaik me fara	<p>Përdorimi i materialeve të ndryshme në mozaik</p> <p>Nëpërmjet materialeve fotografike ose punimeve të nxënësve/eve të tjerë, nxënësit/et orientohen të flasin për përdorimin e materialeve të ndryshme në krijimin e mozaikut. Ata/ato diskutojnë për materialet që kanë përdorur për të krijuar mozaikë dhe për ndryshimin midis mozaikut me letër dhe mozaikëve me fara</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
17		Teknika e monotipit	<p>Vazo me lule në teknikën e monotipit. Nxënësit/et nxiten të flasin mbi teknikat e stampimit që njohin dhe kanë përdorur. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e stampimit si një teknikë e shpejtë dhe që mund të përdoret mbi sipërfaqe të ndryshme. Ata/ato nxiten të krijojnë një vazo me lule, duke përdorur teknikën e monotipit dhe duke ndjekur radhën e punës.</p>			
18	Teknika dhe procese artistike (17 orë)	Stampa me relief	<p>Dekorim mbi letër me teknikën e stampës me relief. Nxënësit/et diskutojnë mbi përdorimin e stampës për arsye dekorative. Ata/ato sjellin shembuj të ndryshëm për këtë si: letrat dekorative të mureve, letrat e ambalazhit, dekorim objektshetj. Për të realizuar këto dekorime stampa me relief është e përshtatshme. Nxënësit/et përzgjedhin modelin e stampës me relief për të bërë dekorimin e tyre.</p>			
19		Stampa me patate	<p>Dekorimi i bluzës me teknikën e stampimit me patate. Nxënësit/et diskutojnë për bluzat me stampa që kanë veshur ose për imazhet e përdorura si ilustrime të mësimt. Ata/ato zbulojnë që stampimi është një teknikë e përhapur dhe me përdorim të gjerë e praktik. Nxënësit/et orientohen të stampojnë bluzat ose një material pëlhere, pasi të kenë gdhendur një ose dy motive në patate.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
20		Teknika fotografike dhe Përdorimi i aparatit	<p>Zbulojmë teknikën fotografike dhe përdorim aparatit fotografik.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mbi rëndësinë e fotografisë sot. Ata/ato flasin për profesionin e fotografit, për aparatit, për fotografitë që kanë realizuar ose për fotografitë që u kanë bërë të tjerët. Pasi njihen me teknikën klasike të realizimit të fotografisë ata/ato realizojnë fotografi në ambientet e shkollës ose jashtë saj.</p>			
21	Teknika dhe procese artistike (17 orë)	Imazhet fotografike dokumentojnë historit.	<p>Histori me fotografi.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mbi imazhe fotografike nga periudha të ndryshme. Ata/ato zbulojnë rëndësinë e fotografisë si dokumentuese të historisë. Nxënësit/et nxiten të krijojnë një histori me fotografi që ilustrojnë momente të ndryshme nga jeta e tyre.</p>			
22		Ftesa e ditëlindjes.	<p>Krijojmë ftesën e ditëlindjes sipas një temate.</p> <p>Nxënësit/et vendosen në një situatë sikur ndodhen përpara festës së ditëlindjes së tyre. Ata/ato duhet të merren me organizimin e ditëlindjes, duke përcaktuar një tematikë për ta bërë sa më interesante. Këtë tematikë ata/ato do ta paraqesin edhe në ftesat që u drejtojnë shokëve/shoqeve. Ata/ato mbledhin të dhëna, ideojnë tematikën dhe realizojnë nëpër grupe kartolinën me një temë të caktuar.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënës	Teknikat e vlerësimit	Burimet
23		Skulptura, relievi	<p>Të krijojnë reliev dekorativ. Nxënësit/et diskutojnë mbi dallimin ndërmjet skulpturës dhe relievit. Ata/ato flasin për përvojat e tyre të punimit në skulpturë dhe në gdhendjen e patates apo sapunit. Nxënësit/et nxiten të krijojnë pllaka dekorative me reliev duke përdorur mjete të ndryshme.</p>			
24	Teknika dhe procese artistike (17 orë)	Modelimi i vazos	<p>Të krijojnë një vazo. Nxënësit/et diskutojnë për vazot qeramike të kultive të ndryshme, për format dhe mënyrat e realizimit të tyre. Ata/ato tregojnë përvojat në këtë teknikë. Nxënësit/et orientohen të ndjekin udhëzimet për të realizuar një vazo me plastelinë ose das. Ata/ato mund të provojnë edhe forma të tjera të vazos.</p>			
25		Përdorimi i relievit si dekorim	<p>Dekorimi i vazos me reliev Nxënësit/et diskutojnë për vazot e dekoruara me reliev. Ata/ato orientohen të bëjnë dekorimin me reliev të vazove që krijuan orën e kaluar. Por mund të krijojnë edhe një vazo tjetër nga fillimi dhe ta dekorojnë me reliev. Nxënësit/et ndjekin udhëzimet e mësuës/ës dhe pastaj krijojnë dekorin e tyre për vazon.</p>			
26		Konstruksioni.	<p>Kulla prej kartoni Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë që kanë për konstruksionet. Ata/ato diskutojnë për materialet që përdoren në ndërtim dhe për llojet e ndryshme të ndërtesave. Pasi vëzhgojnë fotografitë e disa kullave dhe format e tyre ata/ato nxiten të krijojnë një kullë prej kartoni duke ndjekur hapat e punës që i demonstroi mësuësi/ja.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
27		Projekt artistik mbi ndërtesat në vendin tonë.	<p>Ndërtojmë dhe krahasojmë Nxënësit/et mbledhin materiale për ndërtesat tradicionale të periudhave të ndryshme në vendin tonë. Diskutojnë për karakteristikat e tyre dhe i krahasojnë. Në grupe realizojnë nga një ndërtesë, duke përdorur njohuritë e marra te konstruksioni</p>			
28		Arti në parahistori	<p>Zbulojmë artin në parahistori Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi njohuritë e tyre që kanë marrë në lëndën e historisë për artin në parahistori. Ata/ato diskutojnë për pikturat e shpellave, veglat e punës, mënyrën e jetesës, figurinat etj. Duke parë lidhjen e njëritut parahistorik me natyrën ata/ato nxiten të krijojnë logon e një kafshe në zhdukje. Ky krijim shërben për sensibilizimin ndaj ruajtjes së natyrës dhe mjedisit.</p>			
29	Historia, arti dhe shoqëria (8 orë)	Arti egjiptian	<p>Zbulojmë artin egjiptian. Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë për artin egjiptian. Diskutojnë për arkitekturën madhështore të piramidave, skulpturën, pikturën. Nxënësit/et nxiten të krijojnë, duke u msështetur në një prej imazheve të artit egjiptian</p>			
30		Arti grek	<p>Zbulojmë artin grek. Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë dhe të lidhin njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë me imazhet mbi artin grek. Diskutojnë për arkitekturën dhe skulpturën, për teatrin grek, për vazot e pikturuara Nxiten të krijojnë duke u mbështetur në format dhe dekorimet e larmishme të vazove greke.</p>			

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
31		Arti romak	Zbulojmë artin romak. Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë dhe të lidhin njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë me imazhet mbi artin romak. Diskutojnë për arkitekturën, skulpturën, pikturën dhe mozaikun romak. Nxënësit/et nxiten të krijojnë, duke u mbështetur në mozaikët dekorativë të periudhës romake.			
32		Qytetet antike në Shqipëri	Udhëtim në qytetet antike të vendit tonë. Nxënësit/et diskutojnë për njohuritë që kanë mbi këto qytete tërime antike duke u referuar fotografive. Krahasojnë objektet arkeologjike të vendit tonë me ato të qytetërimit grek dhe romak.			
33	Historia, arti dhe shoqëria (8 orë)	Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu	Vizitë në muze (në këtë orë mësimi situata e vizitës në muze mund të jetë reale) Nxënësit/et diskutojnë mbi eksperiencat që kanë në lidhje me vizitat në muze. Ata/ato diskutojnë për muzeun arkeologjik dhe për objektet që ekspozon ky muze.			
34		Projekt: doku-mentimi i objekteve arkeologjike	Të dokumentojmë objektet arkeologjike si pjesë e çmuar e trashëgimisë sonë kulturore. Nxënësit/et diskutojnë mbi detyrën që kanë marrë: dokumentimi i objekteve arkeologjike. Të ndarë në grupe diskutojnë për informacionin që kanë mbledhur mbi objektet e parqeve arkeologjike. Më pas secili/a nxënës/e bën skicimin e objektit dhe vendos të dhënat, duke marrë kështu rolin e dokumentuesit të objekteve të trashëgimisë kulturore.			
35		Ekspozita e fundvitit.	Krijimet tona në ekspozitë Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët. Bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. Ata/ato diskutojnë për të zgjedhur titullin e ekspozitës së tyre. Më pas, nën udhëzimet e mësuesit/es përzgjedhin punët sipas tematikave të ndryshme.			

4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

4.1 Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit/ës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të artit pamor do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete dhe praktike, për të zbuluar mjedisin pamor dhe për të krijuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe nëpërmjet zhvillimit të një kompetence të caktuar, nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit/et drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual e artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me në qendër nxënësin/en dhe në mësimdhënien dhe nxënien e integruar.***

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm/e, për sa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe e metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- Kompetencat kryesore të të nxënit në artin pamor.
- Lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e të aftësive në kuptimin që: ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet.
- Formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor.
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale.
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë.
- Veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup.
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës.

- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe të vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij.
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues/e – nxënës/e në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi/ja dhe nxënësi/ja janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura, dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve. Ata/ato janë aktivë/e kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose stimulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve/eve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata/ato të ndihen të lirshëm/e dhe të zhdërvjellët/a për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi/ja të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “...pse më pëlqen?”, “...a duket bukur?”, “...çfarë ndodh nëse e vendos objektin më afër?” etj. Në këtë mënyrë ai/ajo inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij/saj dhe të ndërmarrë situata të reja.

Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e nxënësve/eve në mësimin e artit. Mësuesit/et duhet të inkurajojnë çdo nxënës/e të besojë se do të jetë i/e suksesshëm/e në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve/eve, nevojat që ata/ato kanë, t’i ndihmojnë të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin, duke diferencuar udhëzimet për nxënës/e me nevoja të veçanta. Ata/ato duhet të stimulojnë dhe inkurajojnë të gjithë nxënësit/et, duke u krijuar atyre mjedise që të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyra që janë të rëndësishme për ta.

Kjo mund të realizohet nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen, me përvojën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materiale, janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit/et duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve/eve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Ata/ato duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të artit pamor që nxit idetë e reja tek nxënësit/et.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin/en që nga njëra anë të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron dhe nga ana tjetër të arrijë të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë të mira për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

4.2. Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit

Situatat e të nxënit për secilin model të planifikimit ditor, është sugjeruese, sepse kërkon të nxisë dhe të orientojë mësuesit/et rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve/eve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin orës mësimore, dhe rrjedhimisht edhe vendosja e rezultateve të të nxënit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore, nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund ta zhvillojë këtë situatë apo temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij.

Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

1. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik Tema mësimore: Perceptimi pamor, iluzionet optike		Situata e të nxënit: Zbulojmë mjedisin që na rrethon nëpërmjet shqisave tona Nëpërmjet imazheve të shfaqura ose nëpërmjet objekteve të ndryshme ftohen nxënësit/et për të diskutuar rolin e shqisave në perceptimin e objekteve. Ata/ato diskutojnë për rëndësinë që ka shqisa e të parit në perceptimin e mjedisit që na rrethon.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i> Kompetenca e të menduarit: (3) <i>Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</i> Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme..</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon. ▪ Reflektton për mënyrën sesi funksionon perceptimi pamor. ▪ Zbulon që drita është faktor i rëndësishëm për perceptimin. ▪ Zbulon që iluzioni optik ndodh kur truri ynë nuk e kupton imazhin. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> ▪ perceptim pamor, ▪ pesë shqisat, ▪ iris, bebëz, retinë, ▪ iluzion optik. 	

<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që ilustron fëmijë që përdorin shqisat për të perceptuar objekte; ▪ imazhe që ilustron mënyrën se si i percepton ato syri ynë; ▪ imazhe që tregojnë iluzione optike. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Shkencat e natyrës. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten fëmijë që përdorin shqisat për të perceptuar objekte të ndryshme (libri, fq. 4, fig. 1). Nxënësit/et nxiten të flasin për njohuritë që kanë mbi shqisat dhe se si ato i ndihmojnë ata/ato për të perceptuar objektet e ndryshme nëpërmjet të parit, prekjes, dëgjimit, shijimit dhe nuhatjes. Nëpërmjet shfaqjes së imazhit të syrit nxënësit/et përqendrohen te shqisa e të parit. Ata/ato tashmë e dinë se nëpërmjet syrit realizohet perceptimi pamor. Ftohen të flasin për pjesët përbërëse të syrit që ata/ato njohin si: irisi, bejba e syrit etj. U shpjegohet që syri është organi kryesor nëpërmjet të cilit njeriu percepton botën që e rrethon dhe se faktori i dritës e bën të mundur këtë. Për ta kuptuar sa më mirë këtë ata/ato duhet të mësojnë se si funksionon syri i njeriut.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shfaq imazhe që ilustron mënyrën e funksionimit të syrit të njeriut (libri, fq. 5 fig.2,3). Këto ilustrime tregojnë që drita ndriçon objektet, ndërsa lënda kristalinë e syrit tonë kur bie në kontakt me dritën fokuson imazhin. Imazhi përcillet në retinë dhe nëpërmjet nervit optik përcillet në tru, i cili e kthen drejt imazhin e kthyer përmbys nga retina. Aparati fotografik funksionon si syri ynë. Nëpërmjet këtij informacioni nxënësit/et duhet të kuptojnë që shqisa e të parit është kryesore për të zhvilluar aftësitë komunikuese në artin pamor. Iluzionet optike janë të rëndësishme për të kuptuar se si orientohet vëmendja jonë pamore (libri, fq. 6 fig.4, 5, 6). Mësuesi/ja shfaq imazhe të cilat truri ynë e ka të vështirë t'i përcaktojë dhe u drejton nxënësve/eve pyetje të tilla: Çfarë shikoni në këto imazhe? Po shikoni dy figura? A janë të barabarta objektet? Sa figura shihni këtu? Përse nuk jemi të qartë në atë që shohim? Nëpërmjet këtyre pyetjeve mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin rreth imazheve që shohin. Mësuesi/ja shpjegon se këto imazhe që truri ynë nuk i përcakton saktë quhen iluzione optike, duke sqaruar gjithashtu edhe arsyen pse truri ynë gabon në këto raste.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Mësuesi/ja shfaq imazhet e perceptimit të objektit nga syri dhe nxënësit/et shpjegojnë se si funksionon syri ynë. Gjithashtu shfaq imazhe të tjera me iluzione optike që shfaqen me figura të dyfishta dhe i fton nxënësit/et të kuptojnë figurat dhe të shpjegojnë përse ato duken ashtu. “Identifikoni figurën në fotografi? A ka figurë të fshehur në foto? Cila është ajo? Sa figura ka në këtë foto?” Nxënësit/et ftohen të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotografitë me iluzione optike (libri, fq. 7 fig.7, 8, 9, 10, 11).</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Vlerësimi i nxënësit/es do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e aftësisë së secilit/ës nxënës/e për të identifikuar dhe argumentuar iluzionin optik në imazhe. 	

2. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Shenja dhe pika.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Shenja dhe pika si shprehje e komunikimit artistik.</p> <p>Nxënësit/et zbulojnë se të gjitha veprat e artit kanë shenjat e tyre karakteristike. Njëpërmjet vëzhgimit dhe përvijës së tyre ata/ato zbulojnë që pika është shenja më e vogël dhe se ajo ofron mundësi të shumta për t'u shprehur. Krijojnë, duke përdorur pikën dhe zbulojnë mënyra interesante të përdorimit të saj në kulturën e popullsisë australiane.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) <i>Krijon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur; krijuese dhe me përgjegjësi.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton shenjat dhe pikat. ▪ Reflektton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon. ▪ Zbulon karakteristikat shprehëse të shenjës dhe pikës. ▪ Krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e pikës. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ shenjë grafike, ▪ shenjë piktorike, ▪ shenjë arkitektonike, ▪ shenja plastike, ▪ pikë. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësve/es; ▪ fotografi që ilustrojnë karakteristikat e shenjave; ▪ fotografi nga natyra që ilustrojnë elementin e pikës; ▪ materiale si: lapsa, lapustila me trashësi të ndryshme, plastelinë, akuarela ose tempera, letra vizatimi, shkop. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <p>Shkenca e natyrës.</p> <p>Teknologjia.</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Mjedis.</p> <p>Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten detaje nga një pikturë, nga një grafikë ose një vizatim, nga një skulpturë dhe nga një sipërfaqe arkitekture. Nxënësit/et nxiten të flasin se çfarë paraqesin këto detaje fotografish. Mësuesi/ja pyet: A është kjo një pjesë e marrë nga një pikturë? Si e kuptojmë këtë? A është kjo një pjesë e marrë nga një vizatim? Si e kuptojmë këtë? Po këto fotot e tjera pjesë e kujt janë? A janë këto pjesë të arkitekturës dhe të skulpturës?

Pikërisht këto janë shenja dalluese të teknikave të ndryshme që realizohen nëpërmjet mjeteve të ndryshme specifike. Në këtë mënyrë kuptohen shenjat specifike të vizatimit që quhen shenja grafike, shenjat e pikturës quhen piktorike, shenjat e skulpturës dhe të arkitekturës quhen përkatësisht: shenja plastike dhe arkitektonike. Këto shenja do t'i kuptohen më mirë gjatë studimit të teknikave artistike (libri, fq. 8, fig. shenjat).

Mësuesi/ja shfaq imazhe fotografike ku shihet se si një bashkësi pikash formon vija dhe konture. Shfaqen imazhe të tjera ku bashkësitë e pikave krijojnë formë (libri, fq. 9, fig. 1, 2). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et për të diskutuar nëpërmjet pyetjeve:

Çfarë shohim në foto? Si janë krijuar konturet e ndërtesës në foton e parë? Po në foton e dytë si janë organizuar ato? A krijojnë këto pika format e objekteve që ndodhen aty? (Pra të gjitha objektet që shohim në foto janë të krijuara nga pika të vogla drite. Ne mund ta përdorim pikën në mënyra të ndryshme për të krijuar figuracione të larmishme.) Po në natyrë ku e shohim pikën? (Pika është një element shumë i vogël që gjendet në natyrë.)

Mësuesi/ja shfaq foto nga natyra dhe i nxit nxënësit/et të identifikojnë pikat dhe mënyrën se si ato janë organizuar në krahët e fluturës, në botën bimore, te insektet, te kafshët, te syri i njeriut apo te yjet në qiell (libri, fotot në fq. 9, 10). Nxënësit/et ftohen të gjejnë shembuj të ndryshëm të paraqitjes së pikave në natyrë, duke u mbështetur në vëzhgimet dhe në njohuritë e mëparshme.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se pika është një element, të cilin mund ta përdorim për të krijuar dhe për të komunikuar ide Madhësia e pikës varet nga mjeti dhe nga sipërfaqja që përdorim. Ai/ajo i fton nxënësit/et të eksperimentojnë mbi një letër, me lapsa e stilolapsa të madhësive të ndryshme. Ky eksperiment mund të përsëritet edhe mbi një sipërfaqe plasteline ku nxënësit/et kuptojnë që presioni i dorës dhe materiali ndikojnë në madhësinë e pikës. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë duke përdorur mundësitë shprehëse të pikës. Ata/ato mund të krijojnë një kompozim në letër sipas pikturave me pika të traditës australiane ose mund të pikturojnë motive me pika mbi gurë. Mësuesi/ja demonstroi radhën e punës dhe i nxit ata/ato të krijojnë duke zgjedhur motive sipas imagjinatës së tyre. Ata/ato mund të zgjedhin bojëra të lëngshme dhe të përdorin një shkop për realizimin e pikave. Detyra në letër mund të realizohet edhe nëpërmjet përdorimit të lapustilave. Ndërsa për të dekoruarë gurin duhet të përdoren bojërat e lëngshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et i vendosin detyrat e realizuara në një vend të dukshëm të klasës dhe diskutojnë. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Kuptojnë që pika është një element që mund ta përdorin në mënyra të ndryshme në krijimet e tyre. Mësuesi/ja u drejton pyetje të tilla si: A ndikojnë madhësia e mjeteve dhe forca që ushtrojmë në cilësinë e pikës? Po në krijimin tuaj? Materiali i përdorur a ndikon te cilësia e letrës? Cili është materiali që zgjodhët ju? Ai/ajo i orienton nxënësit/et që nëpërmjet pikës ata/ato mund të krijojnë punime të larmishme. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëse/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

3. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Vija.</p>		<p>Situata e të nxënit: Të zbulojmë llojet e vijave në natyrë për t’u shprehur nëpërmjet vijës.</p> <p>Vëzhgimi i fotove nga natyra i ndihmon nxënësit/et të zbulojnë aty llojet e vijave dhe larminë e tyre, në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu. Duke zbuluar larminë e llojeve të vijave në natyrë, në mjedisin që i rrethon dhe mundësitë e shumta të përdorimit të vijës nxënësit/et nxiten të krijojnë, duke përdorur këtë element në mënyrë origjinale.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) <i>Krijon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;</i> (3) <i>shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton llojet e vijave. ▪ Reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon. ▪ Zbulon karakteristikat shprehëse të vijës. ▪ Krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e vijës. ▪ Shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të vijës në krijim. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vijë, ▪ vijë horizontale, ▪ vijë vertikale, ▪ vijë e pjerrët, ▪ vijë e ndërprerë, ▪ vijë e shkallëzuar, ▪ vijë e harkuar, ▪ vijë e valëzuar, ▪ vijë spirale.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që ilustron elementin e vijës; ▪ fotografi nga natyra që ilustron karakteristikat e vijës në natyrë; ▪ materiale si: lapsa, lapustila, letra vizatimi. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Shkencat e natyrës. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi/ja shfaq një fotografi nga natyra në të cilën shenjon llojet e ndryshme të vijave që ndodhen aty (libri, fq. 12, fig. 1). Në fotografi shihen: vija horizontale që ndan qiellin dhe tokën, vija vertikale të drurët e urës, vija e harkuar etj. Pra në natyrë ekzistojnë disa lloje vijash. Nxënësit/et ftohen t’i identifikojnë ato në foto të ndryshme dhe të kuptojnë ndjesinë që secila nga ato shkakton (libri, fotot fq. 12, 13, 14). Mësuesi/ja vazhdon të shfaqë foto nga natyra dhe foto me objekte të krijuara nga njeriu ku shfaqen vija horizontale dhe drejton pyetjet:</p> <p>Ç’lloj vije shohim këtu? Vija e horizontit shfaqet si vijë horizontale dhe na krijon ndjesinë e qetësisë. Edhe shkallët janë ndërtuar me vija horizontale. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të identifikojnë llojet e vijave në fotografi të ndryshme nga natyra dhe me objekte të krijuara nga njeriu. Identifikohen vijat vertikale, vijat e ndërprera, vijat e shkallëzuara, vijat e harkuara, vijat spirale. Ai/ajo orienton me pyetjet: Ku i shohim tjetër këto vija? A mund të sillni shembuj të tjerë? Çfarë ndjesie krijojnë këto lloje vijash? (I shohim me radhë bashkë.) Çfarë tregon vija vertikale? A mendoni se krijon qëndrueshmëri? (Kujtoni shprehjen qëndrojmë në këmbë.) Po vija e pjerrët a mendoni se tregon lëvizje? A ju kujton pozicionin që marrim gjatë vrapimit? Po vija e ndërprerë a ju kujton vazhdimësinë dhe drejtimin? A përdoret për vijat e bardha në rrugë? A tregojnë vazhdimësi dhe lëvizje vija e shkallëzuar dhe zigzag? (Këtë ndjesi na e krijojnë shkallët kur ngjitemi.) Por lëvizje tregojnë edhe vijat e harkuara, të valëzuara dhe spirale. (Shikoni me kujdes mënyrën se si zhvillohen ato në natyrë dhe se si përdoren nga njeriu.)</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon që vija është një element i artit pamor dhe nëpërmjet saj ne krijojmë konturin e objekteve. Ajo është një bashkësi pikash ashtu siç u pa te mësimi mbi pikën. Vijnë ne mund ta krijojmë me mjete të ndryshme si: lapsi, stilolapsi, lapustila, peneli etj. Siç e pamë nëpërmjet fotove llojet e vijave ne i gjejmë në natyrë. Nëpërmjet përdorimit të vijës ne mund të shprehim dhe komunikojmë emocione të ndryshme. Ushtrimi i parë në libër na tregon një mënyrë të përdorimit të vijës. Ky ushtrim është një formë eksperimenti që ne mund të kryhet me elementin e vijës. Nëpërmjet vijës mund të krijohen kompozime të ndryshme. Orientohen nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes mënyrën e përdorimit të vijë vijës te peizazhi. Ata/ato nxiten të krijojnë një peizazh sipas dëshirës. Në fillim hedhin idenë në letër dhe vizatojnë objektet ose hapësirat në të. Më pas përzgjedhin ngjyrat dhe mbushin me vija këto hapësira. Është mirë që për secilin objekt ose hapësirë afër njëra-tjetrës të zgjedhin nga një ngjyrë të ndryshme (për të bërë dallimin midis tyre). Ata/ato mund të përdorin lloje të ndryshme vijash në krijimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et nxiten të flasin për krijimet e tyre dhe të shokëve nëpërmjet pyetjeve: Çfarë tregon krijimi yt? Sa lloje vijash ke përdorur? A i ke krijuar vijat në varësi të formës së objektit? Çfarë mjetesh përdore: lapsin apo lapustilat? A është kjo një mënyrë interesante për të krijuar? A mendon se vija është një element i rëndësishëm për të krijuar? Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet vijës mund të krijojnë kompozime të larmishme.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

4. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Tekstura.</p>		<p>Situata e të nxënit: Larmi teksturash natyrale dhe artificiale</p> <p>Vëzhgimi i objekteve nga natyra nëpërmjet fotografive, i nxit nxënësit/et të diskutojnë mbi sipërfaqet e shumëllojshme. Ata/ato zbulojnë teksturën në natyrë dhe teksturën e krijuar nga njeriu në objekte të ndryshme. Zbulojnë dhe krijojnë në mënyrë të pavarur duke përdorur mundësitë shprehëse të teksturës.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) <i>Krijon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;</i> (3) <i>shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon me vëmendje mjedisin që e rrethon dhe percepton llojet e teksturave; ▪ reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; ▪ zbulon karakteristikat shprehëse të teksturës; ▪ krijon duke përdorur në mënyrë të qëllimshme karakteristikat e teksturës; ▪ Shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të teksturës në krijim. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksturë natyrale, ▪ teksturë artificiale.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë shumëllojshmëri teksturash nga natyra, nga bota e kafshëve; ▪ fotografi që tregojnë shumëllojshmëri teksturash artificiale nga objekte të krijuara nga dora e njeriut; ▪ materiale për të krijuar: letër, lapsa, lapustila, rapidograf. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Shkencat e natyrës. Teknologjia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie ku paraqitet një sipërfaqe që përmban ndarje me përbërje të ndryshme (libri. fq. 16, fig. 1). Çdo ndarje përbëhet nga bashkësi erëzash me karakteristika të ndryshme. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Çfarë shihni në figurë? A shfaqen ndryshe këto erëza nga një kuti te tjetra? Si mendoni ju, cila është arsyeja? (Format e erëzave të ndryshme në bashkësi krijojnë sipërfaqe të ndryshme.) A ka çdo objekt një sipërfaqe me karakteristika të veçanta? (Sipërfaqen e çdo objekti e quajmë teksturë.)</p>	

Mësuesi/ja shfaq fotografi nga natyra të objekteve me tekstura të ndryshme dhe i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes, duke u drejtuar pyetje, si: Çfarë ju bie në sy te fotografitë e lëvoreve të pemëve? (libri. fq. 17, fig. 2, 3, 4 secila pemë shfaqet me karakteristika të ndryshme). Mësuesi/ja shfaq fotografi të tjera, të gjetheve në bashkësi, por edhe të gjetheve më vete (libri. fq. 17, fig. 5, 6, 7, 8, 9, 10) dhe drejton pyetje: A formojnë gjethet e bimëve në bashkësi një teksturë? A ka secila gjethe karakteristika të veçanta të teksturës? (Çdo gjethe në veçanti ka teksturë të ndryshme dhe të veçantë. Edhe kur ato janë në bashkësi formojnë tekstura të ndryshme si rrjedhojë e formës së tyre të ndryshme.) A shfaqen shpendët dhe kafshët me tekstura të larmishme? (libri, fq. 17, fig. 11, 12, 13). Cilat janë këto kafshë që shohim në foto? A mund të na thoni kafshë që kanë teksturë interesante? (Të gjithë shembujt për teksturën që pamë janë nga natyra dhe këtë lloj tekture do ta quajmë teksturë natyrale.) Po në jetën e përditshme ku e shohim teksturën?

Mësuesi/ja shfaq objekte të ndryshme me teksturë interesante të krijuara nga njeriu. (libri. fq. 18, fig. 14, 15, 16, 17, 18, 19) dhe pyet: A janë këto objekte të krijuara nga dora e njeriut? Me çfarë materiale janë të krijuara këto objekte? A shfaqet e ndryshme tekstura e secilit objekt? (Materialet e ndryshme kanë karakteristika të ndryshme të teksturës.) A mund t'i quajmë këto tekstura artificiale? Pse?

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se tekstura në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu paraqitet e larmishme. Ai/ajo orienton se çdo material mund të punohet në mënyra të ndryshme për t'i dhënë karakteristika të veçanta sipërfaqes së jashtme dhe pyet: A mund ta përdorni edhe ju teksturën në krijimet tuaja?

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et për të përdorur elementin e teksturës në krijimet e tyre, duke u mbështetur në këtë shumëllojshmëri teksturash dhe në shembujt e ushtrimeve në libër (libri. fq. 19). Sipas shembullit të gjetthes, nxënësit/et mund të zgjedhin të vizatojnë një formë të caktuar gjetheje ose disa prej tyre. Ata/ato mund të përcaktojnë nervin e zgjatimet, dhe çdo ndarje mund ta mbushin me tekstura të ndryshme.

Mund të zgjedhin të vizatojnë një kafshë, dhe ta interpretojnë në mënyrë individuale teksturën e kafshës, duke u mbështetur në imagjinatën e tyre, por edhe në imazhe fotografike (shembujt në libër shërbejnë për të treguar mënyra të ndryshme të përdorimit të teksturës në krijim). Mësuesi/ja i orienton për mjetet që ata/ato mund të përdorin për realizimin e krijimit të tyre. Nxënësit/et duhet t'i zgjidhin vetë problemet krijuese.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et diskutojnë për punët e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që nëpërmjet teksturës mund të krijojnë punime interesante. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Cila është tema që zgjodhe dhe ku u mbështete për të realizuar teksturën në krijimin tënd? Si e realizove dhe cilat materiale përdore? Nxënësit/et kuptojnë që nëpërmjet mundësive shprehëse të teksturës mund të krijojnë punime të larmishme.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënëses/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Forma dydimensionale.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë format natyrale dhe gjeometrike në natyrë</p> <p>Nxënësitet/et rendisin format e njohura natyrale dhe gjeometrike. Fotografitet e ndryshme i ndihmojnë ata/ato të përshkruajnë këto forma. Nxënësitet/et zbulojnë format gjeometrike në natyrë dhe i krahasojnë me format gjeometrike bazë. Nëpërmjet vëzhgimit të veprave të artistëve/eve ata/ato zbulojnë mundësitë shprehëse të formave dydimensionale dhe pastaj krijojnë në mënyrë të pavarur dhe origjinale.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) Krijon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike; (3) shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</p> <p>Kompetenca e të menduarit:(1) Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik; (2) Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</p> <p>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</p> <p>Kompetenca qytetare: (2) Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar format natyrale. ▪ reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon. ▪ zbulon se format bazë gjenden në natyrë; ▪ përdor qëllimisht format natyrale dhe gjeometrike në mënyrë shprehëse, në krijimet e veta; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të formave natyrale dhe gjeometrike në krijim. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ formë dydimensionale, ▪ formë natyrale, ▪ formë gjeometrike. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësitet/es; ▪ fotografi që tregojnë format natyrale, format gjeometrike bazë në natyrë dhe format gjeometrike të krijuara nga njeriu; ▪ mjete pune si: letër, laps, vizore, lapustila, bojëra uji etj. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <p>Shkenca e natyrës.</p> <p>Matematika.</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten figura me kontur. Në një tërësi paraqiten forma të objekteve nga natyra dhe në tjetër formë të ndryshme gjeometrike (libri, fq. 22, fig. 1, 2). Mësuesi/ja drejton pyetjet e tilla: Çfarë shohim në këto imazhe? A janë këto forma të njohura për ju? A i ndajmë këto forma në natyrale dhe gjeometrike? A janë të sheshta këto forma dhe a krijohen nga një vijë e mbyllur?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq fotografi ku paraqiten forma të larmishme nga natyra (libri, fq. 22, fig. 3, 4, 5). Si shfaqen format në natyrë? Ato janë të rregullta dhe të çrregullta. Mësuesi/ja shfaq fotografi me forma nga natyra, të cilat formojnë forma gjeometrike (libri, fq. 23, Fig.6, 7, 8, 9). Çfarë formash shihni këtu? Rrethi, trekëndëshi, katrori, gjashtëkëndëshi. A njihni ju objekte nga natyra që kanë forma gjeometrike? Mësuesi/ja shfaq një foto nga arkitektura ku dallohen format gjeometrike të krijuara nga njeriu. (libri, fq. 23, fig. 10) Mësuesi/ja fton nxënësit/et të identifikojnë format gjeometrike në foto. A mund t'i gjeni format gjeometrike që ndodhen në ndërtesë? A shfaqen të sakta ato? Pra format gjeometrike të krijuara nga njeriu janë të ndërtuara saktë. Mësuesi/ja shfaq foto ku paraqiten vepra arti ku artistët/et kombinonë format gjeometrike mes tyre ose format natyrale me ato gjeometrike (libri, fq. 23, 24, fig. 11, 12, 13). Vëzhgoni me kujdes se si artistët Pol Kle dhe Vasili Kandinskij i kanë përdorur format natyrale dhe gjeometrike.</p>
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se format dydimensionale i ndajmë në forma natyrale dhe në forma gjeometrike. Format gjeometrike bazë i gjejmë në natyrë. Format gjeometrike të krijuara nga dora e njeriut janë të sakta. Mbas kanë parë mënyrën se si dy artistët i kanë përdorur format gjeometrike dhe natyrale nxënësit/et nxiten të krijojnë. Ushtrimet në libër gjithashtu përdoren për nxitjen e punës krijuese. Ata/ato mund të zgjedhin të krijojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – një kompozim si në ushtrimin e parë sipas pikurës së artistit Xhakomo Bala. – një pikurë dekorative duke përdorur forma natyrale sipas imagjinatës së tyre e duke u mbështetur në informacionin që morën. – një dekoracion me figura gjeometrike sipas fantazisë duke parë udhëzimet e ndërtimit të tij. (Në këtë rast mësuesi/ja duhet të shpjegojë që është e nevojshme të përdoret vizorja dhe matjet e sakta.) – një kombinim të formave natyrale me ato gjeometrike. <p>Mbas udhëzimit të mësuesit/es çdo nxënës/e zgjedh mënyrën se si do të zhvillojë krijimin e tij. Gjatë procesit të punës mësuesi/ja vazhdon të udhëzojë nxënësit/et sipas zgjidhjeve personale.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që nëpërmjet përdorimit të formës dydimensionale mund të krijojnë punime të shumëllojshme. Mësuesi/ja drejton këto pyetje: Si i ke përdorur format në krijimin tënd? Përse zgjedhe format natyrale? Përse zgjedhe format gjeometrike? Si i ke kombinuar format me njëra-tjetrën? Në veprën e cilit/ës artist/e u mbështete? Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Vëllimi.</p>		<p>Situata e të nxënit: Të zbulojmë vëllimin nëpërmjet dritës</p> <p>Nxënësit/et zbulojnë se forma dhe vëllimi i objekteve bëhet i dukshëm për syrin tonë nëpërmjet burimit të dritës. Vëllimi i objekteve është i barabartë dritë + hije. Nëpërmjet imazheve ata/ato vëzhgojnë që objekti në pjesën që nuk rrihet nga drita krijon hijen e vet dhe hijen e mbartur. Nxënësit/et nxiten të krijojnë këtë raport të vëllimit në punët e tyre sipas udhëzimeve të ushtrimit.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (3) <i>shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar vëllimin; ▪ reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; ▪ zbulon se drita u jep vëllim objekteve; ▪ përdor dritën dhe hijen për të krijuar vëllimin e objekteve; ▪ vlerëson punën e tij dhe të shokëve; 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëllim, ▪ dritë, ▪ hije e objektit, ▪ hije e mbartur. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë objekte ku duket qartë se nga vjen burimi i dritës; ▪ materiale të tilla si: letër, laps, lapustila, vizore. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <p>Shkencat e natyrës. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Mjedisi.</p>	

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie ku burimi i dritës duket qartë nëpërmjet objektit të paraqitur aty (libri, fq. 26, fig.1). Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: Nga cila anë është burimi i dritës? A e shohim qartë ngjyrën dhe formën e frutave në foto? Po në pjesën e hijes a e kuptojmë formën e frutave? Po në zonën ku drita nuk hyn fare a mund të shohim? (Në këtë mënyrë nxënësit/et kuptojnë që drita bën të mundur që ne të shohim formën e objekteve, ngjyrën dhe vëllimin e tyre.)

Mësuesi/ja shfaq dy fotografi të tjera me të njëjtin objekt. Në njërin nga fotografitë drita është e fortë dhe krijon kontrast, ndërsa në tjetrën objekti shfaqet në një ditë gri kur drita nuk krijon kontraste (libri, fq. 27, fig. 2, 3). Ku qëndron ndryshimi midis këtyre fotografive? Si janë ngjyrat në fotografinë e parë? Në cilën anë bie drita dhe në cilën anë të ndërtesës bie hija? Po në fotografinë e dytë a kemi anë të ndriçuar të ndërtesës dhe anë në hije të saj? Në çfarë momenti dhe kohe është bërë kjo fotografi?

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shfaq fotografi me natyra të qeta ku kontrasti i dritëhijes është shumë i fortë (libri, fq. 28, fig. 4) dhe shpjegon që drita bën të mundur që ne të kuptojmë vëllimin e objekteve nëpërmjet dritëhijes që krijohet. Ai/a jo tregon që hija, e cila ndodhet brenda objektit në zonën e pandriçuar, quhet hija e objektit dhe hija që objekti lëshon në tokë, quhet hija e mbartur. Në fotografi të tjera nxiten nxënësit/et të gjejnë hijen e objektit dhe hijen e mbartur.

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et që në krijimin e tyre të pasqyrojnë objekte ku vëllimi i tyre krijohet nga drita dhe hija. Shembujt e ushtrimeve në libër përdoren për të nxitur nxënësit/et në krijim. Udhëzimi dhe demonstrimi i mësuesit/es është i rëndësishëm për të realizuar detyrën. Nxënësit/et mund të vizatojnë një objekt çfarëdo, direkt nga natyra ose nga imagjinata, apo edhe një objekt nga revistat. Në fillim duhet të përcaktojnë burimin e dritës. Nëse përcaktojnë burimin e dritës me një pikë (ashtu si te shembujt në libër) heqin një vijë drejt kontureve të objektit për të përcaktuar hijen e objektit. Brenda objektit përcaktojnë hijen e tij dhe dritën. Kompozimin e krijuar mund ta punojnë bardhë e zi me laps ose edhe me ngjyra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën se si e krijuan vëllimin e objektit nëpërmjet dritëhijes. Shpjegojnë nëse kanë arritur të tregojnë qartë hijen e objektit, hijen e mbartur në marrëdhënie me burimin e dritës.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

7. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Ngjyra.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Drita burim i ngjyrave në natyrë Nxënësit/et identifikojnë ngjyrat e ylberit dhe dritën si burimi i ngjyrave. Zbërthimi i rrezes së dritës në ngjyrat e ylberit bën që nxënësit/et të kuptojnë procesin e ylberit dhe arsyen pse i shohim ngjyrat e objekteve. Nga njohuritë e mëparshme ata/ato njohin ngjyrat e para dhe të dyta dhe e kanë të lehtë të kuptojnë përbërjen e ngjyrave të treta. Ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta ata/ato i identifikojnë në fotografitë nga natyra. Nxënësit të krijojnë duke përdorur njohuritë që morën për ngjyrën.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurisë: (3) <i>shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</i> Kompetenca e të menduarit:(4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari;</i> Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;</i> Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike;</i> Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar ngjyrat në mjedisin që e rrethon; ▪ reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; ▪ zbulon se ngjyrat krijohen nga drita; ▪ përdor qëllimisht ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta në mënyrë shprehëse; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të ngjyrave në krijim. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ngjyrë, ▪ rrethi i ngjyrave, ▪ ngjyrë e parë, ▪ ngjyrë e dytë, ▪ ngjyrë e tretë, ▪ ngjyrë e ngrohtë, ▪ ngjyrë e ftohtë. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që ilustrojnë njohuritë mbi ngjyrën; ▪ skema e rrethit të ngjyrave; ▪ materiale të tilla si: letër, laps, akuarela. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: Shkencat e natyrës. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedis.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e një fotografie nga natyra dhe të pasur me ngjyra (libri, fq. 30, fig. 1). Nëpërmjet pyetjeve nxiten nxënësit/et të identifikojnë ngjyrat që shohin në fotografi. Mësuesi/ja u kujton nxënësve/eve se në mësimin e mëparshëm ata/ato kuptuan se nëpërmjet dritës ne mund të shohim formën, vëllimin dhe ngjyrën e objekteve. Për këtë i referohemi fizikës, e cila studion zberthimin e rrezeve të dritës.

Mësuesi/ja shfaq ilustrimin ku një rreze e bardhë e dritës përthihet te prizmi dhe zberthet në ngjyra (libri, fq. 30, fig. 2) dhe drejton pyetje të tilla si: A është drita e bardhë?

Çfarë ndodh kur drita kalon nëpërmjet prizmit? Ku e keni parë tjetër këtë fenomen? (Si në rastin e prizmit edhe të ylberit kemi të njëjtin fenomen atë të zberthimit të dritës në spektrin e ngjyrës.) Sa ngjyra janë në spektër?

Mësuesi/ja shfaq një foto, e cila ilustron konceptin e ngjyrës së objekteve (libri, fq. 31, fig. 3) dhe pyet: A e dini ju përse i shohim ngjyrat? Çfarë shihni në figurë? (Rrezja e dritës, e cila përmban spektrin e ngjyrave, godet objektin.) Me çfarë ngjyre shfaqet objekti në syrin tonë? A mendoni ju, se objekti, në këtë rast domatja, i përthithi të gjitha ngjyrat e tjera përveç të kuqes?

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se drita përbëhet nga spektri i ngjyrave ose “ylberi” dhe eksperimenti me prizmin na e tregon këtë. Ngjyrat ne mund t’i shohim nëpërmjet dritës. Objektet përthithin të gjitha ngjyrat e tjera dhe shfaqin në sipërfaqe ngjyrën e tyre përkatëse.

Në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu janë të pranishme ngjyra të shumëllojshme, të cilat ju tashmë i njihni. Mësuesi/ja shfaq rrethin e Itenit dhe fton nxënësit/et të identifikojnë ngjyra (libri, fq. 31, fig. a, b, c, d). Cilat janë ngjyrat e para? Pse i quajmë kështu? Po ngjyrat e dyta cilat janë? Si formohen ato? Në rrethin e madh të ngjyrave shohim edhe ngjyra të tjera. Këto ngjyra quhen ngjyra të treta dhe formohen nga bashkimi i një ngjyre të parë dhe i një ngjyre të dytë. Le t’i identifikojmë me radhë, duke u orientuar edhe nga mënyra se si ato janë të vendosura në rrethin e ngjyrave.

Mësuesi/ja nxjerr fotografi me objekte ose peizazhe ku shfaqen ngjyrat e ngrohta (libri, fq. 32, 4, 5, 6) dhe ngjyrat e ftohta (libri, fq. 32, fig. 7, 8, 9). Cilat ngjyra shihni në grupin e parë të fotove? A na krijojnë këto ngjyra ndjesinë e të ngrohtit? Pse? Këto ngjyra na krijojnë ndjesinë e të ngrohtit pasi lidhen me fenomene që kanë lidhje me ngrohtësinë si zjarri, dielli etj. Për këtë arsye këto ngjyra i quajmë të ngrohta.

Po në grupin e dytë të fotografive cilat janë ngjyrat që shihni? A na krijojnë këto ngjyra ndjesinë e freskisë? Pse? Këto ngjyra na krijojnë ndjesinë e freskisë, sepse kanë lidhje me fenomene të tilla si uji, akulli, hijet etj. Për këtë arsye i quajmë ngjyra të ftohta.

Pasi prezantohen njohuritë e reja mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë duke përdorur njohuritë e marra dhe duke u mbështetur te ushtrimet e librit. Ata/ato mund të përdorin ngjyrat e ylberit për të krijuar një dekoracion sipas idesë së tyre ose mund të zgjedhin të përdorin kombinimin e ngjyrave të para dhe të dyta (ku kombinohen gjithashtu ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta), duke u mbështetur në pikturën e Henri Matis. Gjithashtu ata/ato mund të zgjedhin të përdorin ose ngjyrat e ngrohta, ose ngjyrat e ftohta.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et i vendosin punimet të ndarë në grupe sipas zgjedhjeve që kanë bërë në krijimet e tyre. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e krijimeve dhe kuptojnë që elementi i ngjyrës ofron mundësi të shumta shprehëse.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e:
- në mënyrën e realizimit të detyrës:
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

8. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Hapësira.</p>		<p>Mënyrat e paraqitjes së hapësirës në pikturë ose vizatim.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë se çfarë kuptojnë me fjalën hapësirë në përgjithësi dhe si është ajo rreth tyre. Ata/ato tregojnë se si orientohen në hapësirë në marrëdhënie me objektet e tjera. Fotografi të ndryshme i ndihmojnë ata/ato të lidhin njohuritë e mëparshme me njohuritë e reja.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (3) <i>shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon me qëllim për të identifikuar llojet e ndryshme të hapësirës; ▪ reflekton mbi mënyrën sesi e perceptojmë ne hapësirën; ▪ zbulon karakteristikat dalluese të llojeve të hapësirës dhe disa nga mënyrat e paraqitjes së saj në sipërfaqen dydimensionale; ▪ përdor qëllimisht mënyrën e paraqitjes së hapësirës për të arritur rezultatin e dëshiruar; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e paraqitjes së hapësirës në krijim. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ hapësirë, ▪ hapësirë e brendshme, ▪ hapësirë e jashtme, ▪ treguesit hapësinorë, ▪ mbivendosje, ▪ objektet afër dhe objektet larg. 	

<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që ilustron hapësirën e brendshme të mbyllur, hapësirën e mesme urbane, hapësirën e hapur natyrale; ▪ fotografi që ilustron tre treguesit hapësinorë; ▪ ilustrime veprash arti që ilustron artin trepërmasor dhe atë dypërmasor; ▪ mjete të tilla si: laps letër, lapsa me ngjyra, lapustila ose akuarela. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Shkencat e natyrës, Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Mjedisi</p>
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me pyetje që mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve: Çfarë kuptoni ju me hapësirë? A zhvillohet jeta dhe veprimtaria jonë në hapësirë? Çfarë karakteristikash kanë objektet në hapësirë? A kanë objektet gjatësi, gjerësi dhe thellësi? A mund t'i shohim ne objektet në hapësirë nga të gjitha anët?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq një foto nga një ambient i brendshëm dhome (libri, fq. 36, fig. 1) dhe pyet: Çfarë shohim këtu? A mund ta quajmë këtë një hapësirë të brendshme dhe të mbyllur?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq tri foto, në njërin një hapësirë urbane qyteti, në të dytën një hapësirë brenda në pyll dhe në të tretën një hapësirë të hapur ku syri shkon shumë larg (libri, fq. 36, 37, fig. 2, 3, 4) dhe pyet: A është kjo një hapësirë brenda në qytet? A mund të shkojë vështrimi ynë përtej ndërtesave? Po në fotografinë e pyllit a mund të shikojë syri shumë larg? (Në të dyja rastet shikimi ynë nuk mund të shkojë larg.) Po në foton e tretë a ka kufij shikimi ynë? (Atëherë në dy fotografitë e para kemi dy hapësira të mesme dhe në të fundit kemi një hapësirë të hapur.) Po në art si e shprehim hapësirën me tri përmasa?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq ilustrimin e një skulpture të rrumbullakët dhe të një pikturë (libri, fq. 37, fig. 5, 6.) dhe pyet: A është skulptura me tri përmasa? A mund ta shohim atë nga të gjitha anët? Po piktura sa përmasa ka? (Ndryshe nga skulptura piktura ka dy përmasa.)</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se si paraqitet hapësira në një sipërfaqe me dy përmasa siç është vizatimi dhe piktura. Për këtë shfaq imazhe ku objektet ose hapësirat njëra pas tjetrës vijnë duke u zvogëluar dhe drejton pyetje: (libri, fq. 38, fig. 7, 8, 9): A e vini re që hapësirat e harqeve zvogëlohen sa më shumë largohen nga syri ynë? A ndodh e njëjta gjë edhe me hapësirat midis kolonave të urës dhe me varkat në breg? (Kjo është një mënyrë për të paraqitur hapësirën në sipërfaqen dydimensionale. Thellësinë mund ta shprehim nëpërmjet zvogëlimit të objekteve.) Mësuesi/ja shfaq një foto tjetër (libri, fq. 38, fig. 10) dhe pyet: A duken shapkat më të mëdha sesa pemët dhe njerëzit te vija e horizontit? Pse ndodh kjo? (Pra thellësinë mund ta shprehim edhe duke pasur parasysh se objektet afër shpesh mund të shfaqen më të mëdha se objektet larg, edhe pse ato në realitet janë më të mëdha.) Mësuesi/ja shfaq një foto tjetër ku objektet shfaqen duke fshehur pjesërisht njëri-tjetrin dhe shpjegon se kjo quhet mbivendosje dhe se kjo është një mënyrë tjetër për të shprehur hapësirën mbi një sipërfaqe dydimensionale.</p> <p>Nëpërmjet ushtrimeve të librit ku jepen dy mënyra të paraqitjes së hapësirës, mësuesi/ja i nxit e i orienton nxënësit/et të krijojnë, duke përzgjedhur një nga këto dy mënyra. Ata/ato mund të krijojnë një peizazh, duke përdorur njërin nga këta tregues, sipas imagjinatës së tyre ose duke u mbështetur në shembujt e ndryshëm fotografikë.</p>	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën që kanë zgjedhur për të paraqitur hapësirën dhe se si e kanë realizuar atë. Ata/ato kuptojnë që treguesit hapësinorë janë një mundësi e mirë për të paraqitur hapësirën. Nxënësit/et diskutojnë për punët e tyre dhe të shokëve/shoqeve. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:
 në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.
 në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
 në mënyrën e realizimit të detyrës;
 në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

9. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Baraspesha.</p>		<p>Situata e të nxënit: Baraspesha është simetrike dhe asimetrike</p> <p>Duke iu referuar njohurive të mëparshme nxënësit/et identifikojnë simetrinë dhe asimetrinë në natyrë dhe në objektet e ndërtuara nga njeriu. Ata/ato nxiten të përdorin simetrinë ose simetrinë rrethore në krijimet e tyre. Shembujt e librit i nxisin të bëjnë zgjedhje origjinale në krijimet e tyre.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) Zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike; (3) Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik; (2) Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</p> <p>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</p> <p>Kompetenca qytetare:(2) Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</p>			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon me qëllim për të identifikuar simetrinë dhe asimetrinë në mjedisin rrethues; ▪ reflekton mbi mënyrën se si e perceptojmë në baraspeshën në mjedisin që na rrethon; ▪ zbulon karakteristikat e simetrisë dhe asimetrisë për të arritur baraspeshë; ▪ përdor qëllimisht simetrinë dhe asimetrinë në krijim; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të simetrisë dhe asimetrisë në krijim. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ baraspeshë, ▪ simetri, ▪ simetri rrethore, ▪ asimetri.
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <p>teksti i nxënësit/es;</p> <p>fotografi që tregojnë objekte me simetri, me simetri rrethore dhe objekte asimetrike;</p> <p>materiale të tilla si: letra me ngjyra, revista, lapsa, lapustila, gëshërë, ngjitës.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i></p> <p>Shkencat e natyrës. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i></p> <p>Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazhit të fluturës (libri, fq. 40, fig. 1) dhe drejton këto pyetje: A është flutura e barabartë në të dyja anët e saj? A quhet flutura simetrike? A ndahen objektet simetrike në dy pjesë të barabarata duke iu referuar qendrës së tyre që ndryshe quhet aksi i simetrisë?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq materiale të tjera me figura simetrike nga natyra dhe objekte të krijuara nga njeriu (libri, fq. 41, fig. 2, 3, 4, 5, 6, 7) dhe pyet: A janë simetrike këto objekte? Pse?</p> <p>Mësuesi/ja shfaq fotografi të objekteve nga natyra dhe të krijuara nga njeriu me simetri rrethore (libri, fq. 42, fig. 8, 9, 10) dhe pyet: A kanë formën e rrethit këto figura? Çfarë keni mësuar në gjeometri mbi rrethin? A është çdo pikë e rrethit e baraslarguar nga qendra? A ndodh e njëjta gjë edhe te këto objekte? (Për këtë arsye e quajmë simetri rrethore.)</p> <p>Mësuesi/ja shfaq fotografi me objekte nga natyra dhe të krijuara nga njeriu që janë asimetrike (libri, fq. 42, fig. 11, 12, 13, 14) dhe pyet: A janë simetrike këto objekte? Pse? (Të kundërtën e simetrisë e quaj asimetri.) A na shfaq natyra shumë shembuj të asimetrisë? A mund të thoni disa prej tyre? A mund të jepni shembuj të objekteve asimetrike të krijuara nga njeriu?</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon që me simetri kuptojmë një objekt ose një krijim ku të dyja anët e saj janë të barabarta dhe të baraslarguara nga aksi i simetrisë. Simetri rrethore kemi atëherë kur të gjitha anët e objektit janë të baraslarguara nga qendra. Asimetri kemi atëherë kur objektet nuk shfaqen të njëjta në të dyja anët e tyre, por janë të baraspeshuara (si në një peshore). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë, duke përdorur simetrinë ose simetrinë rrethore, si dhe shpjegon që edhe pasqyrimi në ujë është një formë e simetrisë. Duke u mbështetur në ushtrimet e librit ata/ato mund të zgjedhin të krijojnë një kompozim me pasqyrimin e ujit. Në fillim mund të krijojnë gjysmën e kompozimit nëpërmjet imazheve të gatshme të marra nga revistat dhe më pas mund ta riprodhojnë atë në pjesën e poshtme në formën e një pasqyrimi. Gjithashtu nxënësit/et mund të krijojnë rozeta dekorative me letra sipas udhëzimeve në libër. Rozeta është një ilustrim shumë i mirë i simetrisë rrethore dhe kombinimet për ta krijuar me letër janë të pafundme. Gjatë kohës që nxënësit/et krijojnë mësuesi/ja i nxit dhe i udhëzon.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë se cilën nga llojet e baraspeshës simetrike përdorën në punët e tyre. Ata/ato kuptojnë se përdorimi i simetrisë është mënyra më e thjeshtë për të arritur baraspeshën në krijim. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

10. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik.</p> <p>Tema mësimore: Ekspozita jonë.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Krijimet tona në ekspozitë</p> <p>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (4) Është komunikues efektiv.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: (3) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; (4) Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</p> <p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; (2) Kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; (2) Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet; (3) Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe për krijimin e besimit te të tjerët.</p> <p>Kompetenca qytetare: (1) Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; (2) Respekton punën e vet dhe të të tjerëve; (3) Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zhvillon aftësitë krijuese dhe ndërvepruese; ▪ komunikon në mënyrë efektive me shokët dhe shoqet e klasës; ▪ përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi gjuhën pamore; ▪ diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në krijim. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ekspozitë, ▪ përzgjedhje e punimeve, ▪ vendosje dhe ekspozim.
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijimet e nxënësve/eve të realizuara në tematikën e parë; ▪ mjete të tilla si: tabakë letre, ngjitës, gërshërë, pineska etj. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të diskutojnë për mënyrën se si ndërtohet një ekspozitë, duke u mbështetur në përvojat e tyre në ekspozimin e punimeve. Ai/ajo shpjegon se ata/ato do të krijojnë një ekspozitë me punimet e tyre.</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et se për të hapur një ekspozitë të përbashkët duhet të punojnë në grupe. Ai/ajo e ndan klasën në katër grupe dhe orienton për ndarjen e punës. Grupi i parë së bashku me mësuesin/en do të përzgjedhë punët më të mira, në mënyrë që çdo nxënës/e të jetë pjesëmarrës/e i/e barabartë në ekspozitë. Është mirë që të ketë punime nga secila temë mësimore.

Grupi i dytë i ndan punimet sipas tematikave dhe i kalon te grupi i tretë, i cili bën vendosjen e punëve në tabakë letre. Grupi i katërt përcakton dhe ndan hapësirat ku do të vendosen punimet dhe se si do të vendosen.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et diskutojnë për ekspozitën e tyre, për njohuritë që morën mbi gjuhën pamore dhe se si e përdorën atë në krijim. Ata/ato diskutojnë për mënyrën e bashkëpunimit dhe rezultatin e ekspozitës.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në bashkëpunimin dhe komunikimin me njëri-tjetrin;
- në diskutimet që ata/ato bëjnë mbi njohuritë e marra në gjuhën pamore;
- në përdorimin e fjalorit të duhur artistik.

Tematika: Teknika dhe procese artistike

1. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Teknika e vizatimit.</p>		<p>Situata e të nxënit: Të krijojmë shkallëzimet tonale</p> <p>Mësuesi/ja krijon një atmosferë ku nxënësit/et flasin për njohuritë e tyre mbi teknikën e vizatimit dhe mjetet që ata/ato përdorin në këtë teknikë. Nxënësit/et marrin në dorë lapsa me cilësi të ndryshme dhe i zbulojnë vetë dallimet midis tyre. Nëpërmjet këtyre lapsave ata/ato orientohen të krijojnë shkallëzimet tonale (gradacionet tonale) në mënyrë që të aftësohen t'i përdorin për qëllime të caktuara në punët e tyre.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në artin pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit:(1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e teknikës së vizatimit;</i> ▪ <i>eksperimenton me mjetet e vizatimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit.</i> 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vizatim, ▪ laps, ▪ gomë, ▪ letër, ▪ pluhur grafiti, ▪ argjilë, ▪ tonalitet.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ ilustrime të vizatimeve të artistëve/eve të ndryshëm/me; ▪ mjete të tilla si: laps, letër, gomë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi/ja shfaq imazhe të vizatimeve (libri, fq. 46, fig. 1, 2) dhe pyet nxënësit/et: Me çfarë teknike janë të realizuara këto krijime? A është vizatimi teknika që përdorim më shumë? A realizohen konturet dhe format e objekteve nëpërmjet vizatimit? Cili është mjeti më i zakonshëm për të realizuar një vizatim? Si është i formuar lapsi? Po maja e lapsit? (Maja e lapsit formohet nga pluhuri i grafitit dhe argjila.) A e keni vënë re që disa lapsa lenë shenja të ndryshme mbi letër? (Disa janë të zbehta e disa janë të forta. Kjo ndodh për arsye të përbërjes dhe të pjekjes së lapsave.) Po lapsi dhe letra, sa ndihmojnë në realizimin e vizatimit? (Përveç formës dhe konturit të objekteve vizatimi me laps na ofron mundësi të tjera shprehëse. Një nga këto janë edhe shkallëzimet.)</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se lapsa të ndryshëm lenë shenjë të ndryshme mbi letër, disa të fortë dhe disa të lehtë dhe mund të zgjidhen sipas dëshirës. Kjo kuptohet edhe nga shenja që lapsat kanë: h, hb, b, 2b etj. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të shohin shenjat në lapsat e tyre dhe t’i provojnë mbi letër për të bërë dallimin. Mësuesi/ja vë në dukje se cilësia e lapsit mbi letër varet edhe nga presioni që dora ushtron mbi letër.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të krijojnë shkallëzimet (gradacionet) e lapsit duke pasur parasysh shkallën e fortësisë së lapsit dhe presionin e dorës. Nxënësit/et duhet të zgjedhin katër lapsa me cilësi të ndryshme dhe të vizatojnë në fletën e vizatimit katër kolona të ndara në gjashtë katrorë secila. Ata/ato duhet të fillojnë punën me lapsin më të fortë. Katrorin e parë të një kolone e mbushin duke ushtruar presionin maksimal të dorës. Duke kaluar nga katrori në katror presioni i dorës vjen duke u ulur. Pasi të jenë mbushur të gjashtë katrorët e kolonës, do të shihet dallimi nga një katror te tjetri. Me lapsat e tjerë nxënësit/et i mbushin katrorët duke krijuar shkallëzimet tonale të të gjithë lapsave. Gjatë punës mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et mbi mënyrën si të përdorin presionin e dorës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj. Ata/ato shohin diferencën nga njëra kolonë te tjetri dhe nga një kuti te tjetra. Kuptojnë rëndësinë e presionit të dorës për të krijuar shkallëzimet tonale dhe llojin e lapsit të përdorur. Ata/ato kuptojnë që shkallëzimet tonale mund t’i përdorin në krijimet e tyre për të realizuar ide të ndryshme. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënësit/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

2. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Peizazh me teknikën e vizatimit.</p>		<p>Situata e të nxënit: Krijojmë peizazhin duke përdorur shkallëzimet tonale.</p> <p>Nxënësit/et vëzhgojnë peizazhet fotografike dhe diskutojnë për mënyrën se si shfaqet hapësira në to. Peizazhet në vizatim i orientojnë ata/ato për mënyrën se si e shprehin artistët/et hapësirën nëpërmjet vizatimit. Nxiten ta krijojnë hapësirën në peizazhin e tyre me teknikën e vizatimit duke përdorur shkallëzimet tonale.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit; ▪ përdor me kompetencë mjetet e teknikës së vizatimit; ▪ krijon me teknikën e vizatimit duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së vizatimit. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vizatim, ▪ peizazh, ▪ shkallëzim tonal.
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ ilustrime të peizazheve me teknikën e vizatimit; ▪ fotografi peizazhesh me pemë; ▪ mjete të tilla si: laps, letër, gomë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten peizazhe nga natyra (në këtë rast mund të përdoren edhe peizazhet e përdorura te mësimi i hapësirës dhe njohuritë e marra aty). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin për njohuritë që ata/ato kanë për peizazhin dhe hapësirën nëpërmjet pyetjeve: Çfarë shohim në këto fotografi? A është karakteristike e peizazheve hapësira? A e kuptojmë hapësirën nëpërmjet objekteve që janë aty? Çfarë ndodh me këto objekte kur largohen nga syri ynë? (Hapësirën në peizazh e kuptojmë nëpërmjet objekteve që ndodhen në planet e peizazhit.)</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shfaq një peizazh në vizatim (libri, fq. 47, ushtrimi 2). Ai/ajo i nxit nxënësit/et të vëzhgojnë me vëmendje peizazhin e artistit dhe i orienton ata/ato të shohin se si ai e ka krijuar hapësirën e peizazhit nëpërmjet shkallëzimeve tonale të lapsit. Ai/ajo pyet: A e vini re që shkallëzimet tonale të planit të parë, ku ndodhen edhe pemët, janë më të forta? A bëhen ato më të zbehta në largësi nga syri ynë?

Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një peizazh duke përdorur shkallëzimet tonale. Ata/ato mund të mbështeten në imazhe fotografike të peizazheve (mësuesi/ja i ka lajmëruar një orë më parë për të marrë fotografi me peizazhe nga natyra ose sjell dy-tri imazhe të gjetura nga vetë ai/ajo. Është e rëndësishme që këto imazhe të kenë plane të kuptueshme për këtë grupmoshë). Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et që në fillim të bëjnë ndarjen e planeve dhe të përdorin shkallëzimet tonale duke filluar me planin e parë më të errët (ushtrimi 2 në libër në fq. 47 e ilustron shumë mirë këtë). Më pas nxënësit/et vizatojnë objektet e planit të parë dhe të planeve të tjera, nëse kanë. Ata/ato punojnë si me konturet e objekteve, ashtu edhe me shkallëzimet tonale të tyre. Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për mënyrën se si i përdorën shkallëzimet tonale dhe se si ato i ndihmuan të krijojnë hapësirën. Nxënësit/et kuptojnë që teknika e vizatimit ofron mundësi të shumta shprehëse.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

3. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Teknika e akuaelit.</p>		<p>Situata e të nxënit: Momente të ndryshme të qiellit të krijuara me akuarele.</p> <p>Në klasë krijohet një situatë ku nxënësit/et diskutojnë për njohuritë e tyre për teknikën e akuaelit dhe mënyrën se si ata/ato e kanë përdorur. Mësuesi/ja shpjegon njohuritë e reja dhe demonstroi mënyrën e përdorimit të kësaj teknike. Nxënësit/et nxiten të krijojnë qiellin dhe retë në momente të ndryshme, duke përdorur karakteristikat e akuaelit.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e teknikës së akuarelit;</i> ▪ <i>krijon me teknikën e akuarelit duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit.</i> 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ pikturë, ▪ akuarel, ▪ penel, ▪ gomë arabike, ▪ ujë, ▪ transparente, ▪ letër me rrudha.
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ ilustrime krijimesh në akuarele; ▪ mjete të tilla si: letër, akuarele, penel, ujë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon duke treguar bojërat e akuarelit dhe shfaq një pikturë me akuarel. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve/eve: Çfarë teknike realizojmë nëpërmjet ngjyrave të akuarelit? (nxënësit/et e kanë përdorur edhe më parë këtë teknikë.) Cilat janë mjetet që përdoren në këtë teknikë? Cilat janë karakteristikat e saj? A keni eksperimentuar ju me këtë teknikë? Mbi ç'sipërfaqe punojmë me teknikën e akuarelit? A keni provuar të punoni në letra të ndryshme? Cili është rezultati? A e përdorim të bardhën në teknikën e akuarelit? A e dini pse?</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e akualetit, duke i demonstruar ato. Në këtë teknikë uji është shumë i rëndësishëm për të tretur ngjyrat dhe për t'i përhapur ato në letër. Penelat duhet të jenë të butë. Ngjyra e bardhë nuk e përdoret në teknikën transparente të akualetit. Puna fillohet nga tonalitetet më të lehta. Letra është e rëndësishme, ajo nuk duhet të jetë me shkëlqim, por me pore. Teknika e akualetit përdoret mbi letër të thatë dhe mbi letër të lagur. Në këtë teknikë duhet të jemi të sigurt kur e vendosim ngjyrën pasi nuk mund ta korrigjojmë më.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të eksperimentojnë me teknikën e akualetit në letër të lagur. Në fillim laget peneli me ujë dhe më pas laget letra nëpërmjet penelit. (Në këtë rast mësuesi/ja demonstron procesin e punës). Pasi laget letra, zgjidhet ngjyra e duhur për t'u vendosur mbi të, sipas një vizatimi ose ideje. Në këtë mënyrë vendosen ngjyrat me radhë, duke vëzhguar se si ato ndërhyjnë te njëra-tjetra. Nxënësit/et mund të krijojnë qiellin në momente të ndryshme (duke iu referuar ushtrimit në libër), por ata/ato mund të zgjedhin të zgjedhin të krijojnë detin në momente të ndryshme etj. Kjo teknikë me letër të lagur është shumë e mirë për të arritur efekte të ndryshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mundësitë e shumta që ofron kjo teknikë për të krijuar. Shpjegojnë se si e kanë paraqitur qiellin ose detin në momente të ndryshme, cilat ngjyra kanë përdorur për përzgjedhjen e cilat për stuhinë dhe pse. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënësit/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/es i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

4. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Peizazh me teknikën e akualetit.</p>		<p>Situata e të nxënit: Përdorimi i teknikës së akualetit për krijuar një peizazh.</p> <p>Nxënësit/et vëzhgojnë peizazhet e akualetit. Ata/ato diskutojnë se kanë realizuar edhe më parë peizazhe me laps, lapustila, por edhe me akualet. Ata/ato diskutojnë për mënyrën se si e përdorën akualetin në mësimin e kaluar. Mësuesi/ja demonstron radhën e punës dhe nxënësit/et fillojnë ta krijojnë peizazhin sipas imagjinatës ose duke u mbështetur në modelet fotografike.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo një veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e teknikës së akuarelit;</i> ▪ <i>krijon me teknikën e akuarelit duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së akuarelit.</i> 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ akuarel, ▪ peizazh.
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ ilustrime të peizazheve në teknikën e akuarelit; ▪ mjete të tilla si: letër, akuarele, penel, ujë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare</i> Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazheve të peizazheve në teknikën e akuarelit dhe mësuesi/ja drejton pyetje: Cila është tema e këtyre punimeve? A keni punuar peizazh me teknikën e akuarelit? Si e keni përdorur këtë teknikë? A është e nevojshme ta skicojmë lehtë me laps peizazhin para se të fillojmë të përdorim ngjyrën? (Në mësimin e kaluar thamë që teknika e akuarelit është transparente dhe se nuk e përdorim ngjyrën e bardhë.) A e fillojmë pikturën nga tonalitetet më të lehta?</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi radhën e punës për të krijuar një peizazh me teknikën e akuarelit. Teknika e akuarelit, me të cilën u realizua detyra në mësimin e kaluar, ishte me letër të lagur. Në fillim nxënësit/et vizatojnë me kontur të lehtë hapësirat dhe objektet e peizazhit. Më pas lagin letër me penel. Përzgjedhin ngjyrën e dëshiruar për çdo pjesë të peizazhit dhe e përhapin me penel. Me penelin e ngopur me ujë dhe me ngjyrë krijojnë detajet: pemët, bimët, shtëpitë etj. Nxënësit/et ndjekin radhën e punës sipas demonstrimit të mësuesit/es. Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mundësitë e shumta që ofron kjo teknikë për të krijuar. Shpjegojnë se si e kanë krijuar peizazhin duke ndjekur hapat e duhur.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

5. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Mozaiku me letër.</p>		<p>Situata e të nxënit: Krijojmë një kafshë nëpërmjet mozaikut me letër.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, nga përvoja e tyre, për teknikën e mozaikut me letër dhe për mënyrën e përdorimit të saj . Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të vëzhgojnë mozaikun romak, mënyrën e punimit dhe i orienton që duke u nxitur nga kjo punë të krijojnë një peshk sipas fantazisë së tyre ose të një kafshe tjetër.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e teknikës së mozaikut;</i> ▪ <i>krijon me teknikën e mozaikut, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut.</i> 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ mozaik, ▪ copë guri ose xhami, ▪ mozaik romak, ▪ mozaik bizantin. 	

<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ imazhe të mozaikëve të ndryshëm; ▪ mjete të tilla si: laps, letër, letra me ngjyra, gërshërë, ngjitës. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare</i> Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Mjedisi. Njohja e kulturave.</p>
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazheve të mozaikëve. Mësuesi/ja pyet: Çfarë teknike është kjo? A e njihni ju këtë teknikë? Me çfarë materialesh punohet ajo nga artistët/et? Po ju, çfarë materialesh keni përdorur për të realizuar punimet tuaja me këtë teknikë? A keni përdorur materiale të tjera përveç letrave me ngjyra? Si i presim letrat me ngjyra për të krijuar një mozaik? Cila është rruga që ndiqet për të krijuar një mozaik me letra me ngjyra?</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se teknika e mozaikut është një teknikë antike. Artistët/et për të ndërtuar mozaikun përdorin gurë natyralë, gurë mermeri me ngjyra të ndryshme ose gurë xhami. Mozaiku përdoret për të dekoruar dyshemetë ose muret. Në fillim bëhet vizatimi dhe copëzat me ngjyra ngjiten sipas vizatimit. Kjo teknikë përdoret në periudhat antike në Mesopotami e në Greqi. Romakët e përdorën për të dekoruar muret dhe dyshemetë. Në periudhën e Bizantit përdorën mozaikët u përdorën gurët e xhamit të ngjyrosur. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë mozaikun romak me peshk dhe mënyrën se si është realizuar. (Mund të zgjidhet edhe ndonjë kafshë tjetër, pasi mozaikët romakë janë të pasur me figura kafshësh). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një peshk, apo një kafshë tjetër dhe sipas demonstrimeve të mësuesit/es ta realizojnë në teknikën e mozaikut. Gurët mund të zëvendësohen në letra me ngjyra. Mbas vizatimit, nxënësit/et përzgjedhin ngjyrat e dëshiruara dhe i presin letrat në katrorë të vegjël. Këto katrorë ngjiten me ndihmën e ngjitësit duke u vendosur sipas një ritmi të caktuar. Duhet pasur parasysh që midis katrorëve të lihet hapësirë. Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për mënyrën e realizimit të mozaikut me letër, për ngjyrat që përdorën, për temën që ata/ato zgjodhën dhe radhën e punës që ndoqën. Ata /ato kuptojnë që nëpërmjet kësaj teknike mund të realizojnë idetë e tyre krijuese. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve. 	

6. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Mozaik me fara.</p>		<p>Situata e të nxënit: Përdorimi i materialeve të ndryshme në mozaik.</p> <p>Nëpërmjet materialeve fotografike ose punimeve të nxënësve/eve të tjerë, nxënësit/et orientohen të flasin për përdorimin e materialeve të ndryshme në krijimin e mozaikut. Diskutojnë për materialet që kanë përdorur për të krijuar mozaikë dhe për ndryshimin midis mozaikut me letër dhe mozaikëve me fara. Ata/ato nxiten të krijojnë punimin e tyre origjinal, duke ndjekur hapat e punës së kësaj teknike.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut; ▪ përdor me kompetencë mjetet e teknikës së mozaikut; ▪ krijon me teknikën e mozaikut, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së mozaikut; 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ mozaik me fara. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ imazhe të mozaikëve të realizuar me fara e me materiale të tjera si oriz, makarona etj; ▪ mjete të tilla si: letër, laps, vinovil, fara të ndryshme (fasule të bardha, të kuqe, grurë, thjerrëza me ngjyra të ndryshme, oriz etj). 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten mozaikë të realizuar me fara të ndryshme si: me makarona, oriz etj. Mësuesi/ja drejton pyetjet: A janë këto teknika të mozaikut? A keni krijuar ju mozaik në këtë mënyrë? Ç'loj materialesh keni përdorur? A ndjekim të njëjtën radhë pune për të krijuar mozaik me fara a materiale të tjera, njësoj siç bëhmë me letrën?</p>
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi radhën e punës që duhet ndjekur për të realizuar teknikën e mozaikut me fara dhe i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë mënyrën e realizimit të mozaikëve në libër (ose të zgjedhura nga mësuesi/ja). Mësuesi/ja u ka kërkuar nxënësve/eve një orë më parë që të marrin me vete materialet e duhura për realizimin e mozaikut. Sa më shumë fara të ndryshme aq më shumë mundësi për ngjyra ka. Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et të krijojnë një kompozim me një figurë ose më shumë, duke u mbështetur te fantazia e tyre. Farat duhet të jenë të ndara nëpër gota të vogla për ta bërë punën më të lehtë. Pasi krijojnë vizatimin ata/ato vendosin ngjytës në pjesët e vizatimit. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të përdorin vinovil pasi në këtë mënyrë farat ngjiten më mirë. Në vendet me ngjytës vendosen farat sipas përzgjedhjes dhe kjo vazhdon deri në përfundimin e detyrës. Mësuesi/ja monitoron klasën gjatë kohës që nxënësit/et punojnë.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit, vështirësitë që hasën dhe diskutojnë për larminë e materialeve që mund të përdoren për teknikën e mozaikut. Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet kësaj teknike mund të realizojnë idetë e tyre. Diskutojnë edhe për temën që kanë zgjedhur dhe ngjyrat që kanë përdorur dhe përshtatur. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës të secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

7. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Teknika e monotipit</p>		<p>Situata e të nxënësve: Vazo me lule në teknikën e monotipit:</p> <p>Nxënësit/et nxiten të flasin mbi teknikat e stampimit që njohin dhe kanë përdorur. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e stampimit si një teknikë e shpejtë dhe që mund të përdoret mbi sipërfaqe të ndryshme. Ata/ato nxiten të krijojnë një vazo me lule me teknikën e monotipit, duke ndjekur radhën e punës.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit me monotip;</i> ▪ <i>Përdor me kompetencë mjetet e teknikës së monotipit;</i> ▪ <i>Krijon me teknikën e monotipit duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>Shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së monotipit;</i> 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teknika stampimi, ▪ monotip.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi ilustruese me teknikën e monotipit; ▪ mjete të tilla si: letër me sipërfaqe të lëmuar ose sipërfaqe plastike, tempera ose akuarela me tubet, një rul gome ose nje lugë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazheve të teknikave të ndryshme të stampimit. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin mbi përvojat e tyre krijuese me teknikën e stampimit, duke pyetur: Cilat mjete stampimi keni përdorur më parë? A ju ka pëlqyer kjo teknikë? Çfarë karakteristikash kanë punimet e bëra me të? A është një teknikë e shpejtë? Cilat janë materialet mbi të cilat mund të stampohet? Ju keni veshje të stampuara dhe njihni objekte të ndryshme të dekoruara me teknikën e stampimit. Përmendni disa prej tyre. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të krijojnë një vazo me lule në teknikën e monotipit.</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se teknika e monotipit është një teknikë stampimi dhe demonstroi radhën e punës së saj. Me këtë teknikë mund të përftohet vetëm një imazh. Teknikat e stampimit janë ato teknika të përfutuara prej kalimit të imazhit nga një sipërfaqe në tjetrën. E njëjta gjë ndodh edhe me teknikën e monotipit. Për të realizuar idenë nëpërmjet kësaj teknike duhet një sipërfaqe e lëmuar. Me tubetat e ngjyrave krijohet figura e dëshiruar (një natyrë e qetë me lule). Me ngjyrat, duke i përzgjedhur ato sipas dëshirës, njëkohësisht vizatohet dhe pikturohet. (Për të bërë vizatimin mund të përdoret edhe lapsi e pastaj të vendosen ngjyrat). Ngjyrat duhet të jenë pastoze. Mbi të vendoset me kujdes fleta e vizatimit dhe sipërfaqja e saj shtypet me rul ose me një lugë, që letra të ngopet me ngjyrën. Më pas letra çohet me kujdes. Imazhi i përfutur ka krijuar efekte të rastësishme për shkak të përhapjes së ngjyrës.

Për të krijuar vazon me lule nxënësit/et mbështeten në imagjinatën ose në imazhe të përzgjedhura fotografike.

Gjatë kohës që ata/ato punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për mundësitë e shumta shprehëse që ofron kjo teknikë. Ata/ato kuptojnë që nëpërmjet kësaj teknike mund të realizojnë krijime të ndryshme shumë interesante. Nxënësit/et diskutojnë për karakteristikat e kësaj teknike dhe të papriturat që ajo krijon.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

8. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Stampa me relief</p>		<p>Situata e të nxënësve: Dekorim mbi letër me teknikën e stampës me relief:</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mbi përdorimin e stampës për arsye dekorative. Ata/ato sjellin shembuj të ndryshëm për këtë si, letrat dekorative të mureve, letrat e ambalazhit, dekorimi i objekteve, etj. Për të realizuar këto dekorime stampa me relief është e përshtatshme. Nxënësit/et përzgjedhin modelin e stampës me relief për të bërë dekorimin e tyre.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit me relief;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e teknikës së stampimit me relief;</i> ▪ <i>krijon me teknikën e stampimit duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit me relief.</i> 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ stampim me relief, ▪ dekorim.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <p>teksti i nxënësve/es;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ fotografi që tregojnë shumëllojshmëri stampimesh për dekorim; ▪ mjete të tilla si: objekte të gatshme të përshtatshme për stampë me relief, ose mjete për t'i realizuar vetë stampat (p.sh: spango, kuti kartoni, karton, gërshtë, ngjithës etj), ngjyra tempera ose akuarela me tubet. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të dekorimeve me stampë, të tilla si: letra muri për dekorim, letra dekorative për ambalazh, ku motivi përsëritet në mënyrë ritmike. Mësuesi/ja pyet: Për çfarë i përdorim këto letra dekorative? A do t'ju pëlqente të dekoronit muret me to? A do t'ju pëlqente ta zgjidhnit vetë motivin për të dekoruar? A do t'ju pëlqente ta krijonit vetë motivin? A do t'ju pëlqente që t'i krijoni vetë letrat me të cilat mbështillni dhuratat? A e dini ju cila është teknika e përshtatshme për realizimin e tyre? Pse motivi përsëritet? Këto letra dekorative do të realizohen me teknikën e stampimit me relief.</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se letrat dekorative janë realizuar me teknikën e stampimit dhe se përsëritja e motivit është edhe karakteristikë e kësaj teknike dhe e këtij lloj dekorimi. Ai/ajo u tregon nxënësve/eve se do të krijojnë letra dekorative, duke i realizuar vetë stampat. Në vijimësi, ai/ajo tregon disa stampa të gatshme me relief (lodra të vogla e forma të ndryshme) dhe u shpjegon nxënësve/eve se shpesh për stampime mund të përdoren edhe objekte të thjeshta, të cilat gjenden të gatshme ose krijohen. Një kuti e vogël kartoni mund të mbështillet me fije spango duke krijuar një relief vija-vija (libri, fq. 53, fig. b). Ngjyrosjet pjesa e spangos sipas dëshirës dhe përdoret si stampë mbi letër. Mënyra se si vendoset stampa mbi letër, kombinimi dhe ritmi që ndiqet e bëjnë të veçantë këtë dekorim. Mësuesi/ja demonstroi edhe një mënyrë tjetër të krijimit të stampës. Përsëri mbi një kuti të vogël kartoni mund të krijohej figura sipas dëshirës (libri, fq. 53, fig. a). Te letra e kartonit, mund të priten forma sipas dëshirës: një flutur, një pilivesë, një lule, pra çfarëdo. Pasi pritet nga letra e kartonit, të tëra ose pjesë-pjesë, ngjitet te kutia e kartonit. Në këtë mënyrë krijohet një stampë tjetër me relief. Ngjyrosjet e gjithë figura ose me një ngjyrë, ose me disa ngjyra dhe stampohet mbi letër. Përsëri vendosja, kombinimi dhe ritmi që ndiqet -kanë rëndësi për dekorimin. Nxënësit/et orientohen të krijojnë stampat e tyre e më pas dekorimet. Gjatë përdorimit të kësaj teknike nxënësit/et nxiten të kenë parasysh edhe kombinimin e ngjyrave si: ngjyrat e ngrohta me të ftohta, përdorimin e dy ngjyrave ose me shumë etj.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, për mënyrën e realizimit të stampës dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për zgjedhjet që bënë, për mënyrën e kombinimit dhe të ritmit që ndoqën për të realizuar letrat e tyre dekorative. Ata/ato flasin për mundësitë e shumta të përdorimit të kësaj teknike në punimet e tyre dhe për objektet e ndryshme që ata/ato mund të dekorojnë.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Stampa me patate.</p>		<p>Tema mësimore: Dekorimi i bluzës me teknikë n e stampimit me patate.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë për bluzat me stampa që kanë veshur ose për imazhet e përdorura për ilustrimin e mësimi. Ata/ato zbulojnë që stampimi është një teknikë e përhapur dhe me përdorim të gjerë e praktik. Nxënësit/et orientohen të stampojnë bluzat ose materiale pëlhure, pasi të kenë gdhendur një motiv ose dy motive në patate.</p>	
<p>Rezultatet e të nxëniti sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) <i>Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (2) <i>Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxëniti të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit me relievin e krijuar me patate; ▪ përdor me kompetencë mjetet e teknikës së stampimit me relievin me patate; ▪ krijon me teknikën e stampimit duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit me relievin e patates; 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ relief me patate, ▪ dekorim i bluzës. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë bluza ose tekstile të dekoruara; ▪ mjete të tilla si: patate, bisturi, tempera ose akuarele në tubet, bluza ose pëlhurë e bardhë. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të dekorimeve me stampë, të tilla si: bluza, mbulesa, basma, ku motivi përsëritet në mënyrë ritmike. Mësuesi/ja pyet: Cili është materiali mbi të cilin është përdorur teknika e stampimit? A do t'ju pëlqente të dekoronit bluzën tuaj, fustanin, apo diçka tjetër? A do t'ju pëlqente ta zgjidhnit vetë motivin për të dekoruar? A do t'ju pëlqente ta krijonit vetë motivin? Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të dekorojnë bluzën ose pëlhurën duke përdorur stampën e patates.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se stampa e patates është përsëri një stampë me relief dhe demonstroi mënyrën se si ajo krijohet, duke treguar në fillim mjetet që duhen përdorur. Pataten e ndahet në dy pjesë. Me një majë të mprehtë vizatohet një motiv i thjeshtë që mund të jetë një figurë gjeometrike, një flutur, një lule etj. (libri, fq. 53, fig. a, b). Me ndihmën e bisturisë (duke pasur kujdes të mos priten) presin pjesën e tepërt, duke çliruar motivin në formën e relievit. Realizohen dy motive me dy gjysmat e patates dhe përdoren të dyja për stampimin e pëlhurës ose bluzës. Edhe në këtë rast, ka shumë rëndësi kombinimi dhe ritmi që përdoret në dekorim. Një rëndësi të veçantë zënë ngjyrat dhe kombinimi i tyre. Ngjyrat mund të përdoren direkt nga tubeti, por edhe mund të përzihen.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën. Mësuesi/ja duhet të jetë i kujdesshëm dhe t'u ofrojë ndihmë nxënësve/eve gjatë kohës që përdorin bisturinë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të stampës dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për zgjedhjet që bënë për mënyrën e kombinimit dhe të ritmit që ndoqën për të realizuar letrat e tyre dekorative. Ata/ato flasin për mundësitë e shumta të përdorimit të kësaj teknike në punimet e tyre dhe për objektet e ndryshme që ata/ato mund të dekorojnë.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Teknika fotografike dhe përdorimi i aparatit.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë teknikën fotografike dhe përdorim aparatit fotografik.</p> <p>Nxënësiet/et diskutojnë mbi rëndësinë e fotografisë sot. Ata/ato flasin për profesionin e fotografit, për aparatit, për fotografitë që ata/ato kanë realizuar ose për fotografitë që u kanë bërë të tjerët. Pasi njihen me teknikën klasike të realizimit të fotografisë ata/ato realizojnë fotografi.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurisë: (2) Kupton drejt mesazhet, që u adresohet. (5) Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurisë në art pamor.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; (4) Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: 1) Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</p> <p>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</p> <p>Kompetenca qytetare: (1) Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p> <p>Kompetenca digjitale: (2) Njih dhe përdor mjetet audio, video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera etj.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të fotografisë; ▪ përdor një aparat të thjeshtë fotografik për një qëllim të caktuar; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e shumta shprehëse të fotografisë. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teknika fotografike, ▪ fotografi, ▪ aparat fotografik, ▪ zhvillimi i filmit, ▪ stampimi i fotografisë. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësiet/es; ▪ fotografi që ilustron teknikën klasike të fotografisë; ▪ aparat fotografik. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi. Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqitet një fotograf në çastin e shkrepjes së aparatit. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve/eve për të kujtuar njohuritë e mëparshme mbi fotografinë: Çfarë shohim në këtë fotografi? A ju pëlqen fotografia? A ju pëlqen të realizoni fotografi? A keni realizuar fotografi të bukura? Çfarë ju pëlqen të fotografoni më shumë? Për të realizuar një fotografi cilësore çfarë është e rëndësishme? (Për të realizuar fotografi të bukura është e rëndësishme aftësia e fotografit për të kapur momentin e veçantë.) Po ju a keni realizuar ndonjëherë fotografi të veçanta? (Për të realizuar fotografi të veçanta është e rëndësishme edhe aftësia për të përdorur aparatin.)

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon duke shfaqur imazhe që ilustrojnë filmin fotografik, zhvillimin dhe stampimin e fotografisë. Fjala “fotografi” e ka prejardhjen nga greqishtja dhe do të thotë “shkrim nëpërmjet dritës”. Parimi i fotografisë bazohet në zbulimin se disa substancave kimike janë të ndjeshme ndaj dritës. Një material, i cili përmban këto substanca, bëhet i ndjeshëm ndaj dritës dhe është në gjendje të ruajë imazhin. Ky material është filmi fotografik. Teknika fotografike kalon nëpër tri faza: shkrepja e aparatit, zhvillimi i filmit dhe stampimi. Realizimi i kësaj teknike i përket teknologjisë së aparatit me film. Realizimi i një fotografie cilësore varet nga aftësia e fotografit për të përdorur aparatin dhe për të kapur momentin e duhur. Sot ne përdorim aparate digjitale, të cilat janë shumë të thjeshta për t’u përdorur (edhe telefonat celularë sot realizojnë fotografi mjaft të mira, përse i përket cilësisë).

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve/eve përdorimin e aparatit fotografik dhe i nxit ata/ato të bëjnë fotografi. Nxënësit/et mund të dalin në ambientet e oborrit të shkollës ose brenda në klasë. Mësuesi/ja i udhëzon të kompozojnë mirë figurën ose figurat brenda kuadratit. Ata/ato realizojnë fotografi të ndryshme me njëri-tjetrin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në fund të orës së mësimi mësuesi/ja i kalon fotot e aparatit në kompjuter dhe i shohin të gjithë bashkë. Nxënësit/et diskutojnë për fotografitë e realizuara, për mënyrën se si i kanë kompozuar. Nxënësit/et kuptojnë që fotografia sot luan një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin e ideve dhe që është mënyra kryesore e komunikimit pamor në ditët e sotme.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në aftësinë për të diskutuar dhe bashkëpunuar me të tjerët.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Imazhet fotografike dokumentojnë histori.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Histori me fotografi.</p> <p>Nxënës/et diskutojnë mbi imazhe fotografike nga periudha të ndryshme. Ata/ato zbulojnë rëndësinë e fotografisë si dokumentuese të historisë. Nxënës/et nxiten të krijojnë një histori me fotografi që ilustrojnë momente të ndryshme nga jeta e tyre.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurës: (1) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet. (5) Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurës në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarës: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; (4) Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarës për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p> <p>Kompetenca digjitale: (2) <i>Njih dhe përdor mjetet audio, video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera etj.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të fotografisë; ▪ krijon një histori ose tregim nëpërmjet imazheve fotografike; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e shumta shprehëse të fotografisë. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ histori me fotografi, ▪ dokumentim. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënës/ës; ▪ fotografi nga periudha të ndryshme historike; ▪ fotografi nga veprimtaritë dhe ngjarjet jetësore të nxënësve/eve. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi. Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësuesi/ja fillon mësimin duke shfaqur fotografi të vjetra që dokumentojnë momente të ndryshme nga historia (libri, fq. 55, fig. 6, 7) dhe pyet: Çfarë shohim në këto fotografi? Përse janë të rëndësishme imazhet fotografike? Për çfarë shërbejnë ato? A janë pjesë e historisë këto fotografi? (Nëpërmjet fotografive ne mësojmë për ngjarjet e ndryshme historike, për vendet e ndryshme e mënyrën se si ato janë zhvilluar.) A ndodh edhe me fotografitë tuaja e njëjta gjë kur shihni momente të kaluara të jetës suaj dhe të familjes? Po ju a keni fotografi që ju kanë bërë prindërit në momente të ndryshme të jetës? A është bukur dhe interesante kur shihni veten tuaj se si keni qenë të vegjël? A tregojnë ato fotografi pjesë nga historia e jetës dhe e familjes tuaj?

Ndërtimi i njohurive të reja

Nëpërmjet fotografisë mund të komunikohen emocione të ndryshme dhe të dokumentohen momente të rëndësishme të historisë dhe të jetës sonë. Fotografia është padyshim mënyra më e përhapur e komunikimit nëpërmjet imazhit. Edhe pse mund të mos ketë cilësi artistike, ajo ka një vlerë të madhe historike, dokumentuese dhe shkencore. Ato që një fotograf fotografon sot, nesër do të jenë pjesë e historisë, ashtu siç janë pjesë e historisë fotografi të bëra vite më parë. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë një histori me fotografitë që ata/ato kanë marrë. Këto janë fotografi nga momente të ndryshme të jetës së tyre.

Nxënësit/et përzgjedhin fotografitë sipas dëshirës, të cilat mund të tregojnë momente nga pushimet, apo nga ditëlindjet e tyre në vite etj. Ata/ato vendosin fotografitë sipas një radhe të caktuar dhe shkruajnë nga një koment poshtë çdo fotografie. Fotografitë dhe komentet së bashku krijojnë një histori. Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për historitë që ata/ato ndërtuan me fotografitë e tyre. Ata kuptojnë që imazhi fotografik është një mënyrë shumë interesante dhe mjaft e përhapur në ditët e sotme. Ata/ato diskutojnë për fotografi që tregojnë momente të veçanta dhe interesante. Nxënësit/et kuptojnë që nëpërmjet fotografisë mund të dokumentojnë momente të ndryshme të rëndësishme nga jeta e tyre.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Ftesa e ditëlindjes.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Krijojmë ftesën e ditëlindjes sipas një tematike.</p> <p>Nxënësit/et vendosen në një situatë sikur ndodhen përpara festës së ditëlindjes së tyre. Ata/ato duhet të merren me organizimin e ditëlindjes duke përcaktuar një tematikë për ta bërë sa më interesante. Këtë tematikë ata/ato do ta paraqesin edhe në ftesat që u drejtojnë shokëve/shoqeve. Ata/ato mbledhin të dhëna, ideojnë tematikën dhe realizojnë secili/a nëpër grupe kartolinën me një temë të caktuar.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (1) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet.</i> (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të grafik-dizajnit; ▪ përdor me kompetencë mjetet të ndryshme artistike për të realizuar idenë; ▪ krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese në fushën e grafik-dizajnit. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ grafik-dizajn, ▪ projekt artistik, ▪ kartolina, ftesa. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë dizajnin e kartolinave dhe ftesave të ndryshme; ▪ imazhe që ilustrojnë punën e grafik-dizajnit; ▪ mjetet e punës në varësi të teknikës që çdo nxënës/e do të zgjedhë për të realizuar ftesën e tij. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjinë.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: njohja e kulturave, të drejtat e njeriut</p>	

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të kartolinave të urimit, të ftesave për ditëlindje etj. Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve/eve: A keni dërguar kartolina urimi për raste festash dhe ditëlindjesh? A i zgjidhni ato në përshtatje me festën dhe me moshën e personit që ia dërgoni? Po kur organizoni ditëlindjen tuaj a u dërgoni ftesa shokëve? A ka lidhje ftesa me festën që organizoni? A i keni bërë ndonjëherë vetë ftesat e ditëlindjes për shokët? Çfarë të dhënash vendosni në ftesë? Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve/eve se ata/ato do të realizojnë një ftesë për ditëlindjen e tyre. Këtë detyrë, ata/ato mund ta realizojnë në formën e një projekti artistik duke u ndarë në grupe.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon se, profesioni ku përfshihen veprimtari të tilla artistike si: faqosja e librave, e revistave, e gazetave; ilustrimi i librave, reklamat e produkteve se, ftesat, etj. quhet grafik-dizajn. Grafik-dizajnet kanë aftësi krijuese për të ndërtuar një projekt artistik dhe për ta realizuar atë. Ata/ato i realizojnë krijimet e tyre nëpërmjet programeve kompjuterike. P.sh: nëse ata/ato do të realizojnë ftesa për ditëlindje, në fillim bëjnë punë përgatitore për projektin, duke mbledhur të dhëna si: cila është ose do të jetë tematika e festës? Në çfarë moshe është fëmija që ka ditëlindjen? Çfarë do t'u pëlqente më shumë nxënësve/eve të kësaj moshe? Ku do të zhvillohet festa?

Mësuesi/ja i ndan nxënësit/et në grupe dhe i orienton.

Grupet vendosin në fillim tematikën e festës që mund të jetë: piktorët e vegjël, në pishinë, emri i një personazhi të parapëlqyer etj. dhe shohin shembuj të ndryshëm të ftesave për t'u orientuar.

Pasi të kenë diskutuar në grup dhe vendosur për tematikën ata/ato janë të lirë/a ta realizojnë kartolinën e tyre me teknika sipas dëshirës. Çdo nxënës/e sipas tematikës së përbashkët të grupit realizon idenë e tij/saj, duke dhënë kështu secili/a propozimin e tij/saj për ftesën.

Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë punën, secili grup prezanton projektin dhe produktin (ftesën e ditëlindjes). Ata/ato flasin për tematikën e zgjedhur e për të dhënat që kanë mbledhur dhe pastaj propozojnë kartolinën më të mirë të grupit. Nxënësit/et kuptojnë që grafik-dizajni është një profesion krijues dhe dizajni duhet të jetë i aftë të zgjidhë një problem në mënyrë krijuese. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike. Tema mësimore: Skulptura (relievi).</p>		<p>Situata e të nxënësve: Të krijojnë relief dekorativ. Nxënësit/et diskutojnë mbi dallimin ndërmjet skulpturës dhe relievit. Ata/ato flasin për përvojat e tyre të punimit në skulpturë dhe në gdhendjen e patates apo sapunit. Nxënësit/et nxiten të krijojnë pllaka dekorative me relief, duke përdorur mjete të ndryshme.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:(5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i> Kompetenca e të menduarit:(1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i> Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i> Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i> Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të skulpturës (relievit); ▪ përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar idenë në teknikën e relievit; ▪ krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron teknika e relievit; 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ skulpturë, ▪ relief, ▪ skulpturë e rumbullakët, ▪ modelim, ▪ gdhendje. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë skulpturën e rumbullakët, relievin, modelimin me baltë dhe gdhendjen; ▪ mjete të tilla si: plastelinë ose das, rul, mjete të ndryshme për të krijuar relievin teksturor si shkopinje e stampa të ndryshme. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare: Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjinë. Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p style="text-align: center;">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten skulptura të rrumbullakëta, relieve, skulptura me modelim në baltë, skulptura gjatë procesit të gdhendjes. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin rreth skulpturës dhe përvojave të tyre në këtë teknikë. Ai/ajo u kërkon nxënësve/eve të bëjnë dallimin midis dy fotografive ku shfaqet procesi i modelimit dhe ai i gdhendjes. Mësuesi/ja i pyet ata/ato se ku qëndron dallimi në këto dy teknika dhe i ndihmon që të përcaktojnë bashkërisht modelimin dhe gdhendjen. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të bëjnë dallimin midis dy fotografive ku shfaqen një skulpturë e rrumbullakët dhe një relief. Mësuesi/ja shpjegon që ata/ato do të realizojnë një relief dekorativ.</p>
<p style="text-align: center;">Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shfaq relieve dekorative me motive të ndryshme. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et duke demonstruar mënyrën dhe radhën e punës për të krijuar relievin dekorativ (ose teksturën nëpërmjet relievit): krijohet një sipërfaqe e sheshtë me plastelinë (mund të përgatiten disa të tilla). me mjetet përkatëse, krijohen tekstura të larmishme mbi këto sipërfaqe duke ndjekur kombinime dhe ritme të ndryshme; këto lloj teksturash krijohen nëpërmjet gërricjes dhe shenjës që lënë këto mjete mbi plaste-linën e butë; mund të krijohen pa fund pllaka dekorative, duke përdorur fantazinë. mjetet për të krijuar mund të jenë të ndryshme. Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>
<p style="text-align: center;">Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë për larminë e teksturave që mund të krijojnë në relief dhe i bashkojnë të gjitha relievet së bashku, për të bërë një të tërë, duke krijuar një hapësirë dekorative me relief. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p style="text-align: center;">Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Modelimi i vazos.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Të krijojmë një vazo.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë për vazot qeramike të kulturave të ndryshme, për format dhe mënyrat e realizimit të tyre. Ata/ato tregojnë përvojat në këtë teknikë. Nxënësit/et orientohen të ndjekin udhëzimet për të realizuar një vazo me plastelinë ose das. Ata/ato mund të provojnë edhe forma të tjera të vazos.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:(5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit:(1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të plastelinës; ▪ përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar vazon; ▪ krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron plastelina. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ plastelinë, ▪ vazo, ▪ enë qeramike. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi vazosh qeramike për funksione të ndryshme; ▪ mjete të tilla si plastelinë (argjilë) ose das, rul ose shishe, letër, gërrshërë. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjinë.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi. Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p style="text-align: center;">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të vazove. Vazot mund të jenë nga kultura të ndryshme dhe të kenë forma të larmishme. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin rreth vazove dhe pyet: A keni realizuar vazo më parë? Për çfarë përdoren vazot? Çfarë formash kanë ato? Me çfarë materiali realizohen? Mësuesi/ja shpjegon se ata/ato do të realizojnë një vazo me një teknikë të caktuar.</p>
<p style="text-align: center;">Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se modelimi i vazove është një teknikë antike e përdorur që nga koha kur njeriu filloi të ndërtonte objekte të përdorimit të përditshëm, për të përgatitur dhe ruajtur ushqimin. Përveç funksionit utilitar, ato kanë edhe funksion dekorativ. Të dyja këto funksione e kanë shoqëruar gjithmonë artin e poçerisë.</p> <p>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të realizojnë një vazo të thjeshtë duke ndjekur këto hapa:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përgatitet një model letre, baza dhe sipërfaqja anësore, në përmasat e dëshiruara dhe në varësi të materialit të plastelinës; ▪ plastelina përhapet mbi një sipërfaqe duke përdorur një shishe ose një rul brumi; ▪ plastelina pritët sipas modelit të letrës të bërë për bazën dhe për anët; ▪ bashkohen të gjitha pjesët, duke i ngjitur mirë me njëra-tjetrën; ▪ vazos mund t'i krijohet edhe një kapak duke përdorur modelin e letrës së bazës. <p>Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>
<p style="text-align: center;">Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et i vendosin vazot e tyre në një vend të dukshëm në klasë. Flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë që mund të krijojnë vazo edhe me forma të tjera gjeometrike përveç asaj të cilindrike që realizuan.</p> <p>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p> <p>(Mësuesi/ja shpjegon që orën tjetër ata/ato do të vazhdojnë dekorin e vazos me relief).</p>
<p style="text-align: center;">Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Përdorimi i relievit si dekorim.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Dekorimi i vazos me reliev</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë për vazot e dekoruara me reliev. Ata/ato orientohen të bëjnë dekorimin me reliev të vazove që krijuan orën e kaluar. Por ata/ato mund edhe të krijojnë një vazo tjetër nga fillimi dhe ta dekorojnë me reliev. Nxënësit/et ndjekin udhëzimet e mësuesit/es dhe pastaj krijojnë dekorin e tyre për vazon.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:(5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit:(1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të plastelinës; ▪ përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar dekorimin e vazos me reliev; ▪ krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron plastelina. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vazo, ▪ dekorim me reliev. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë vazo të dekoruara me teknika të ndryshme, pikturë, reliev; ▪ mjete të tilla si: plastelinë ose das. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjinë.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Mjedisi. Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të vazove, të cilat janë të dekoruara me relief, me gërricje ose me ngjyra. Nxënësit/et nxiten të flasin për dekorimet e vazove dhe karakteristikat e veçanta që ka çdo dekorim. Mësuesi/ ja i pyet: Cilën teknikë keni përdorur më parë për të dekoruar vazot? Cila është teknika e dekorimit që ju pëlqen më shumë?
Mësuesi/ ja i inkurajon nxënësit/et të mendojnë një dekorim në relief për vazon që krijuan herën tjetër.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ ja shpjegon se ata/ato u njohën me relievin më parë dhe krijuan pllaka dekorative nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme. Mësuesi/ ja i orienton nxënësit/et të dekorojnë vazon nëpërmjet relievit, duke e shtuar materialin e plastelinës në figuracione të ndryshme. Nxënësit/et mund të përdorin vazon që kanë përgatitur një orë më parë ose mund të krijojnë një tjetër në formën e dëshiruar. Mësuesi/ ja shpjegon se për dekorimin, nxënësit/et mund të përdorin figura gjeometrike ose figura natyrale, si gjethe, lule, kafshë etj. Plastelinës i jepet forma e duhur dhe vendoset mbi sipërfaqen e vazos. Mësuesi/ ja demonstroi radhën e punës dhe teknikën e realizimit të dekorimit me relief. Nxënësit/et nxiten të krijojnë një dekorim me relief sa më origjinal.
Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ ja monitoron klasën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et i vendosin vazot e dekoruara në një vend të dukshëm dhe diskutojnë. Ata/ato flasin për punën e tyre, për mënyrën e realizimit, për vështirësitë që hasën, për motivin që përdorën në vazot e tyre. Ata/ato diskutojnë nëse dekorimi me plastelinë e ka ndryshuar formën e vazos dhe pse. Nxënësit/et kuptojnë që nëpërmjet relievit mund të krijojnë vazo shumë origjinale dhe interesante.
Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike.</p> <p>Tema mësimore: Konstruksioni.</p>		<p>Situata e të nxënit: Kulla prej kartoni Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë që ata/ato kanë për konstruksionet. Ata/ato diskutojnë për materialet që përdoren në ndërtim dhe për llojet e ndryshme të ndërtesave. Pasi vëzhgojnë fotografitë e disa kullave dhe format e tyre, ata/ato nxiten të krijojnë një kullë prej kartoni, duke ndjekur hapat e punës që i demonstroi mësuesi/ja.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:(5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit:(1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (4) <i>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të konstruksionit; përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një konstruksion; krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore; shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron konstruksioni.</i></p>		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ konstruksion, ▪ strukturë, ▪ materiale të ndërtimit, ▪ shtylla, ▪ mure, ▪ dysHEME, ▪ tavane. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë konstruksione ndërtesash me materiale të ndryshme; ▪ materiale të tilla si: karton, vizore, laps, gërshtë, ngjitës. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare: Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjinë. Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike ku paraqiten lloje të ndryshme të ndërtesave, të cilat janë me materiale të ndryshme (libri, fq. 60, fig. 1, 2, 3). Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të diskutojnë mbi konstruksionet duke u drejtuar pyetje të tilla si: Me çfarë materiali është ndërtuar shtëpia? A keni parë ju shtëpi prej druri? A mund të na tregoni disa ndërtesa prej guri që keni parë? Po kalatë a janë të ndërtuara prej guri? Po Kulla Eifel me çfarë materiali është ndërtuar? A njihni ju struktura prej metali? Cilat janë materialet që përdoren për ndërtim? Cilat janë pjesët përbërëse të ndërtesave? Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve/eve që ata/ato do të ndërtojnë një konstruksion me karton.</p>
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve/eve që një ndërtesë ose konstruksion për të qëndruar në këmbë duhet të ketë shtylla mbajtëse, mure mbajtëse, trarë, harqe, dysheme dhe tavan. Këto janë elementet arkitektonike. Ndërtesat përbëhen edhe nga elemente përbërëse siç janë muret dhe dekoret.</p> <p>Mësuesi/ja shfaq fotografi me konstruksione kullash dhe udhëzon nxënësit/et t'i vëzhgojnë. Shembujt janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ kulla e Babelit dhe mënyra se si ajo lartësohet drejt qiellit (fig. 4); ▪ kulla veneciane e Durrësit në formë cilindri, e cila është e ndërtuar me gurë të madhësive të ndryshme (fig. 5); ▪ kulla e vitit 1781 në Irlandë, e cila ka një formë të rregullt gjashtëkëndore (fig. 6). <p>Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të vëzhgojnë me vëmendje mënyrën se si janë të ndërtuara këto konstruksione kullash dhe i orienton të realizojnë një kullë duke ndjekur disa hapa. Ai/ajo orienton se për ndërtimin e konstruksioneve është e rëndësishme saktësia dhe ekui-libri i pjesëve.</p> <p>Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et i vendosin konstruksionet e tyre në një vend të dukshëm dhe diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën e realizimit dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato kuptojnë që për të ndërtuar konstruksione të qëndrueshme është e rëndësishme të merren parasysh elementet arkitektonike. Me karton ata/ato mund të ndërtojnë forma të ndryshme të konstruksioneve.</p> <p>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit/et</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; ▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike. Tema mësimore: Projekt artistik mbi ndërtesat në vendin tonë.</p>		<p>Situata e të nxënit: ndërtojmë dhe krahasojmë. Nxënësit/et mbledhin materiale për ndërtesat tradicionale të periudhave të ndryshme në vendin tonë. Diskutojnë për karakteristikat e tyre dhe i krahasojnë. Nxënësit/et në grupe realizojnë nga një ndërtesë duke përdorur njohuritë e marra te konstruksioni.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi për të zgjidhur probleme të ndryshme artistike;</i> (3) <i>Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike</i> (3) <i>Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;</i> (3) <i>Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</i></p> <p>Kompetenca digjitale: (1) <i>Gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të konstruksionit;</i> ▪ <i>përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një konstruksion;</i> ▪ <i>krijon duke përdorur elemente të gjuhës pamore;</i> ▪ <i>shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese që ofron konstruksioni.</i> 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ndërtesë karakteristike, ▪ banesë, ▪ fabrikë, ▪ ndërtesë moderne, ▪ kështjellë. 	

<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Materiale fotografike mbi ndërtesa të periudhave të ndryshme, kështjella, banesa, fabrika etj; ▪ skica e vizatime ndihmëse që çdo grup ka bërë gjatë mbledhjes së materialeve; ▪ mjete pune të tilla si: kuti kartoni, ristela, shkopinj, letra me ngjyra ose revista, bojra etj. (materialet janë të përzgjedhura nga secili grup në varësi të projektit që ata/ato do të realizojnë). 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Historia. Matematika. Teknologjia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Trashëgimia jonë kulturore. Mjedisi.</p>
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Nxënësit/et janë ndarë paraprakisht në grupe. Secili grup ka mbledhur materiale fotografike, ka bërë skica mbi ndërtesat karakteristike në vendin tonë, kështjellat, fabrikat etj. Çdo grup ka zgjedhur ndërtesën që do të ndërtojë dhe ka mbledhur materialet e nevojshme. Një anëtar/e i grupit bën prezantimin e tipit të ndërtesës së zgjedhur, të karakteristike të saj, dhe të mënyrës se si do ta realizojnë atë. Është mirë që grupet të kenë zgjedhur ndërtesa të periudhave të ndryshme: një grup zgjedh kështjellat, grupi tjetër një banesë karakteristike, një grup një fabrikë e një tjetër një ndërtesë moderne.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Grupet fillojnë punën për ndërtimin e ndërtesës së përzgjedhur gjatë punës së tyre paraprake. Nxënësit/et duhet të kenë parasysh elementet e arkitekturës që e bëjnë një ndërtesë të qëndrojnë në këmbë dhe elementet e tjera plotësuese si dritaret, dyert, çatia etj. Materialet që ata/ato përdorin janë përzgjedhur në bazë të ndërtesës që do të krijojnë. Kutia e kartonit mund të jetë një material i përbashkët për të gjitha grupet dhe asaj ata/ato i japin formën e dëshiruar. Gjatë kohës që nxënësit/et të ndarë në grupe punojnë mësuesi/ja monitoron klasën.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, secili grup prezanton punimin e tij. Ata/ato diskutojnë se si i kanë realizuar karakteristikat e ndërtesës së tyre, për materialet që kanë përdorur dhe për vështirësitë që hasën. Mbas prezantimit të secilit grup nxënësit/et fillojnë të bëjnë krahasimet midis ndërtesave të periudhave të ndryshme.</p> <p>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re. ▪ në vlerësimin e punës së secilit grup; ▪ në mënyrën e realizimit të detyrës; ▪ në vlerësimin e bashkëpunimit dhe të përfshirjes së punës në grup; ▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve. 	

Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.

1. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Arti në parahistori.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë artin në parahistori.</p> <p>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/ et nxiten të diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë për artin në parahistori. Ata/ato diskutojnë për pikturat e shpellave, për veglat e punës, për mënyrën e jetesës, për figurinat etj. Duke parë lidhjen e njeriut parahistorik me natyrën ata/ato nxiten të krijojnë logon e një kafshe në zhdukje. Ky krijim shërben për të sensibilizuar mbi ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet; (3) Shpreh qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të parvarur, krijuese dhe me përgjegjësi; (2) zgjidh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon veprat e artit të periudhës parahistorike; ▪ reflekton mbi mënyrën e jetesës së njerëzve duke kaluar nga shpellat në ndërtimin e kasolleve; ▪ zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në neolit dhe paleolit; ▪ krijon duke u mbështetur në lidhjen që njerëzit e asaj periudhe kishin me natyrën; ▪ shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ parahistori, ▪ paleolit (epoka e gurit), ▪ neolit, ▪ palafite, ▪ grafit, ▪ gur megalitik, ▪ Stonehenge. 	

<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi me imazhe ilustruese mbi periudhën e paleolitit dhe të neolitit; ▪ mjete të tilla pune si: letër, laps, lapsa me ngjyra ose lapustila. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazhit të një pikturë në shpellë dhe i nxit nxënësit/et të flasin për njohuritë që ata/ato kanë mbi periudhën e paleolitit dhe të neolitit. Ata/ato flasin për mënyrën e jetesës së njerëzve të kësaj periudhe, për materialet që përdornin, për veglat e punës dhe për veprimtaritë e tyre kryesore.</p> <p>Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes pikurat e shpellave dhe të flasin për figuracionin e tyre.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se çfarë paraqesin pikurat e shpellave dhe se çfarë domethënie kishte arti për njerëzit e paleolitit. Ai/ajo i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhet e veglave të punës dhe imazhet e skulpturës. Mësuesi/ja shpjegon teknikat e përdorura dhe domethënien e imazheve. Në drejtimin e mësuesit/es dhe duke parë imazhet e palafiteve, nxënësit/et diskutojnë se si ndryshoi mënyra e jetesës nga jeta në shpella në fshatra të organizuara, si dhe karakteristikat e këtyre ndërtesave. Ata/ato diskutojnë për enët qeramike dhe grafitet në neolit. Duke vëzhguar imazhin e Stonehenge-s nxënësit/et diskutojnë për arkitekturën e gurëve të mëdhenj megalitikë dhe marrin informacion mbi të.</p> <p>Duke u nisur nga lidhja e ngushtë që njerëzit e asaj periudhe kanë pasur me natyrën dhe kafshët, mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të krijojnë logon e një kafshe në zhdukje. Ai/ajo shpjegon se sot shumë kafshë janë në zhdukje, siç është ariu panda apo elefanti i bardhë dhe pyet: A dini ju kafshë të tjera që janë në rrezik zhdukjeje?</p> <p>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të zgjedhin një kafshë që është në rrezik zhdukjeje dhe ta kthejnë në simbol për mbrojtjen e kafshëve, si simboli i elefantit të bardhë ose i ariut panda.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et diskutojnë për punën e kryer dhe për kafshët që kanë zgjedhur për t'i kthyer në simbol për mbrojtjen e kafshëve që rrezikojnë zhdukjen. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e artit në paleolit dhe neolit dhe për teknikat që artistët/et e asaj periudhe përdornin.</p> <p>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; ▪ në realizimin e detyrës duke u mbështetur në veprat e periudhës historike. 	

2. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Arti egjiptian</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë artin egjiptian.</p> <p>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësve/et nxiten të diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë për artin egjiptian. Ata/ato diskutojnë për arkitekturën madhështore të piramidave, për skulpturën, për pikturën. Nxënësve/et nxiten të krijojnë duke u mbështetur në një nga imazhet e artit egjiptian.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurisë: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (2) <i>zgjdh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit egjiptian; ▪ zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin egjiptian; ▪ krijon duke u mbështetur në veprat e artit egjiptian; ▪ shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ arti egjiptian, ▪ mastaba, ▪ piramida, ▪ sfinksi, ▪ piktura dhe skulptura egjiptiane, ▪ kanuni egjiptian. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësve/es; ▪ fotografi që tregojnë imazhe të artit dhe të arkitekturës egjiptiane; ▪ mjete të tilla si: letër, laps, lapsa me ngjyra etj. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p style="text-align: center;">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazhit të piramidave. Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et se kujt kulture i përkasin ato. Nxënësit/et nxiten të flasin mbi njohuritë që kanë marrë në histori për Egjiptin dhe karakteristikat e shoqërisë egjiptiane të asaj kohe. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e piramidave, për çfarë shërbenin dhe me çfarë materiali janë ndërtuar. Mësuesi/ja tregon formën më të hershme të piramidave dhe më pas piramidat e Gizës.</p>
<p style="text-align: center;">Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon nga kush dhe pse janë ndërtuar piramidat e Gizës. Figura e sfinksit ilustron edhe më shumë rolin e faraonit në shoqërinë egjiptiane të kohës. Me ndihmën e imazheve që mësuesi/ja shfaq nxënësit/et diskutojnë për përmasat dhe karakteristikat e skulpturës egjiptiane.</p> <p>Mësimi vazhdon me shfaqjen e imazheve të pikturës egjiptiane. Diskutohet për tematikat që përdornin artistët/et në pikturë, ku përdorej ajo, për ngjyrat dhe për mënyrën e paraqitjes të figurës së njeriut.</p> <p>Mësuesi/ja shfaq skemën e paraqitjes së figurës së njeriut sipas kanunit egjiptian dhe i orienton të vëzhgojnë dhe diskutojnë për këto rregulla.</p> <p>Ai/ajo i fton nxënësit/et të vëzhgojnë disa nga shpendët që paraqiten në pikturat egjiptiane, si dhe mënyrën realiste e me detaje të realizimit të tyre. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et që, duke u mbështetur në këto imazhe, të krijojnë edhe ata/ato figurën e rosës (ose të ndonjë shpendi tjetër). Nxënësit/et duhet të kenë parasysh krijimin e teksturës së puplave dhe për këtë mësuesi/ja u rikujton njohuritë e marra te tekstura.</p>
<p style="text-align: center;">Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve mbi karakteristikat e artit egjiptian, mbi temat e përdorura, mbi materialet që përdornin skulptorët egjiptianë, mbi paraqitjen e figurës së njeriut, mbi funksionin e piramidës. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën se si i realizuan shpendët, dhe i krahasojnë me pikturën egjiptiane. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p style="text-align: center;">Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; ▪ në realizimin e detyrës duke u mbështetur në veprat e periudhës historike.

3. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Arti grek.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë artin grek</p> <p>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë dhe të lidhin njohuritë e tyre që kanë marrë në lëndën e historisë me imazhet e artit grek. Ata/ato diskutojnë për arkitekturën dhe skulpturën, për teatrin grek, për vazot e pikturuara Nxënësit/et nxiten të krijojnë duke u mbështetur në format dhe në dekorimet e larmishme të vazove greke.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur; krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (2) <i>zgjdh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit grek; ▪ zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin grek; ▪ krijon duke u mbështetur në veprat e artit grek; ▪ shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe, duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ arti grek, ▪ periudhë e artit grek, ▪ tempull, ▪ stilet arkitektonike, ▪ teatër, ▪ skulpturë, ▪ vazo e pikturuar. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë imazhe të artit dhe të arkitekturës nga historia e artit grek; ▪ mjete të tilla si: laps, letër, lapsa me ngjyra ose lapustila. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p style="text-align: center;">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e imazhit të tempullit grek, diskutohet mbi objektin dhe se cilës kulturë i përket. Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin mbi njohuritë që ata/ato kanë marrë në histori për Greqinë antike: Si quheshin qytetet greke, për ndërtesat karakteristike, për Akropolin.</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se arti grek ndahet në katër periudha artistike (ose tre, nuk është gabim) sipas karakteristikave përkatëse që shfaq ky arti në secilën periudhë.</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se tempulli grek ishte shtëpia e perëndive dhe i fton të gjejnë elementet arkitektonike më të dukshme të tempullit.</p>
<p style="text-align: center;">Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shfaq tri llojet e shtyllave, të cilat përcaktojnë tri stilet e arkitekturës dhe i nxit nxënësit/et të zbulojnë karakteristikat e secilës. Teatri grek është një ndërtesë e rëndësishme e arkitekturës dhe e qytetërimit grek. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të gjejnë pjesët kryesore të ndërtesës dhe të diskutojnë për rolin që kishte teatri.</p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon me shfaqjen e skulpturave të disa periudhave të artit grek. Mësuesi/ja shpjegon materialin me të cilin punoheshin këto skulptura dhe funksionin që luante skulptura në artin grek. Ata/ato nxiten të diskutojnë për figurat e atletëve që merrnin pjesë në Olimpiadë.</p> <p>Vazot greke janë dëshmi e pikturës greke. Shfaqen vazot e periudhës gjeometrike, vazot me figura të zeza dhe sfond të kuq dhe anashjelltas. Nxënësit/et inkurajohen të identifikojnë karakteristikat e tyre.</p> <p>Nxënësit/et nxiten të krijojnë, duke u mbështetur te motivet gjeometrike, te format e larmishme dhe te ngjyrat karakteristike të vazove greke (jepen shembuj për këtë). Ata/ato vizatojnë në fletë, një vazo dhe e dekorojnë me motive gjeometrike të vazove greke. Ata/ato përzgjedhin një formë sipas dëshirës.</p>
<p style="text-align: center;">Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve mbi karakteristikat e artit grek, mbi arkitekturën, mbi skulpturën dhe funksionet e saj, mbi teatrin grek, mbi pikturën e vazove. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, për mënyrën se si i realizuan vazot e tyre duke i krahasuar me ato greke.</p> <p>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>
<p style="text-align: center;">Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; ▪ në realizimin e detyrës, duke u mbështetur në veprat e periudhës historike.

4. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Arti romak.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Zbulojmë artin romak</p> <p>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësve/et nxiten të diskutojnë dhe të lidhin njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë me imazhet e artit romak. Ata/ato diskutojnë për arkitekturën, për skulpturën, për pikturën dhe për mozaikun romak. Nxiten të krijojnë duke u mbështetur në mozaikët dekorativë të periudhës romake</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (2) <i>zgjidh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit romak; ▪ zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin romak; ▪ krijon duke u mbështetur në veprat e artit romak; ▪ shpreh mendimin e vet rreth veprave të artit të kësaj periudhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ art romak, ▪ Koloseu, ▪ ujësjellësat romakë, ▪ harku i triumfit, ▪ domus, ▪ skulpturë dhe pikturë romake, ▪ mozaik. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teksti i nxënësve/es; ▪ Fotografi që tregojnë imazhe të artit romak; ▪ Mjete të tilla si: laps, letër, letra me ngjyra ose lapustila. 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare: Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare: Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me shfaqjen e imazhit të Koloseut si simbol i qytetërimit romak. Orientohen nxënësit/et të flasin për qytetërimin romak duke u mbështetur në njohuritë e marra në histori. Ata/ato diskutojnë se ku u zhvillua qytetërimi romak, si ishte i organizuar qyteti i Romës dhe mbi kulturën romake. Çfarë ndërtese ishte Koloseu dhe për çfarë shërbente. Nxënësit/et orientohen ta krahasojnë Koloseun me teatrin grek dhe të kuptojnë që ai është një amfiteatër në formë elipsi.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shfaq imazhe nga arkitektura romake si: ujësjellës, harkun e triumfit, dhe shpjegon karakteristikat e tyre arkitektonike dhe funksionale. Mësuesi/ja shpjegon mënyrën e organizimit të qytetit në Romë, duke treguar funksionet që luanin godinat e gjetura nga arkeologët/et. Ndarjen në shtresa të qytetarëve/eve romakë/e e tregojnë edhe banesat e destinuar veç për të pasurit dhe veç për popullin e thjeshtë. Skulpturat romake paraqisnin fitoret në beteja dhe triumfin e gjeneralëve romakë. Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e skulpturës romake dhe si ajo u mbështet te arti etrusk dhe grek. Veprimtaria vazhdon me shfaqjen e pikturave të Pompeit dhe diskutohet mbi karakteristikat e tyre. Mozaiku është një teknikë shumë e përdorur nga romakët. Diskutohet mbi përdorimet e saj dhe materiali me të cilin punohej. Duke u nisur nga motivet e mozaikëve romakë nxënësit/et nxiten të krijojnë një dekoracion të thjeshtë për dysheme në fletën e tyre. Gurët mund të imitohen me katrorë të vegjël të ngjyrosur me lapsa ose lapustila.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Pasi mbarojnë, nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve mbi karakteristikat e artit romak, mbi arkitekturën, skulpturën dhe karakteristikat e saj, mbi amfiteatrin, pikturat murale dhe mozaikun. Ata/ato diskutojnë për punën e tyre, mënyrën se si e realizuan idenë e një mozaiku dekorativ për dysheme, duke bërë krahasimin me shembujt e mozaikëve romakë. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në realizimin e detyrës duke u mbështetur në veprat e periudhës historike.

5. Planifikimi ditor

data.....

(shënim: kjo temë mësimore mund të zhvillohet edhe në formë vizite në një nga parqet arkeologjike)

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Qytetet antike në Shqipëri.</p>		<p>Situata e të nxënit: Udhëtim në qytetërimet antike në vendin tonë.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë për njohuritë që ata/ato kanë mbi këto qytetërimet antike në vendin tonë duke iu referuar fotografive. Ata/ato krahasojnë objektet arkeologjike të vendit tonë me ato të qytetërimit grek dhe romak.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (2) <i>zgjdh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: 1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vëzhgon veprat e artit dhe arkitekturën e qyteteve antike në Shqipëri; ▪ zbulon karakteristikat e shprehjeve artistike dhe teknikat e përdorura në artin e qyteteve antike në Shqipëri; ▪ vlerëson objektet arkeologjike të qyteteve antike në Shqipëri si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore; ▪ krahason objektet arkeologjike të qyteteve antike në Shqipëri me kulturat Greke dhe Romake. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ qytetet antike Butrinti, Apolonia, Durrësi (Dyrrahu), ▪ teatër, ▪ amfiteatër, ▪ park arkeologjik, ▪ monumenti i Agonotetëve. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që tregojnë imazhe nga arkitektura, skulptura dhe mozaikët e zbuluara në qytetet antike në Shqipëri. 		<p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <p>Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike të ndërtesave më karakteristike të qyteteve antike. Nxënësit/et nxiten të flasin se kujt qyteti i përkasin këto objekte, nëse i kanë vizituar ndonjëherë dhe çfarë njohurish kanë për to. Duke treguar teatrin e Butrintit mësuesi/ja i orienton të gjejnë ngjashmërinë me teatrot greke, ose ngjashmërinë e monumentit të Agonotetëve me ballinat e tempullit grek; ngjashmërinë e amfiteatrit të Durrësit me ato romake.</p>
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e ndërtesave të Butrintit duke shfaqur imazhe nga ky qytet. Shpjegon vendndodhjen e parkut arkeologjik dhe periudhat e zhvillimit të tij nëpërmjet karakteristikave të ndërtesave më të njohura të tij. Më pas mësuesi/ja shpjegon funksionin që ka pasur monumenti i Agonotetëve në Apoloni dhe stilin e tij arkitektonik. Mësuesi/ja shfaq monumentin më të njohur në qytetin e Durrësit, amfiteatrin, dhe u shpjegon nxënësve/eve që ai është ndërtuar në periudhën e romakëve, gjë që ata/ato e panë edhe në ngjashmërinë që ky amfiteatër ka me amfiteatrot romake.</p> <p>Mësuesi/ja shfaq imazhet e skulpturave të gjetura në këto qytete dhe shpjegon funksionin e tyre të lidhur ngushtë me arkitekturën, si dhe tematikën e tyre. Veprimtaria vazhdon me shfaqjen e mozaikëve si pjesë e teknikave artistike të lëvruara në këto qytete. Shpjegohen karakteristikat e tyre.</p> <p>Mësuesi/ja shfaq disa foto të parqeve arkeologjike në vendin tonë dhe udhëzon nxënësit/et se çfarë duhet të kenë parasysh kur vizitojnë këto parqe (si të organizuar me shkollën ashtu edhe me prindërit).</p> <p>Gjatë vizitës në një park arkeologjik ka rëndësi:</p> <p>Vëzhgimi me kujdes i objekteve arkitektonike të mbetura dhe i karakteristikave të tyre. Kujtohen njohuritë e marra në mësimet mbi antikitetin dhe krahasohen me ato që shihen aty.</p> <p>Ndjekja me vëmendje e tregimeve të ciceronit dhe drejtojtimi i pyetjeve për gjërat që nuk kuptohen.</p> <p>Fotografimi i monumenteve më të rëndësishme dhe i detajeve që tërheqin vëmendjen.</p> <p>Diskutimi me shokët dhe shoqet mbi karakteristikat e ndërtesave, objekteve.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Në fund të orës së mësimit nxënësit/et diskutojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ mbi ndikimin që patën qytetet antike në Shqipëri nga kultura greke dhe romake duke bërë krahasime. ▪ mbi monumentet më të rëndësishme në këto qytete. ▪ mbi skulpturën dhe mozaikun. ▪ ata/ato shprehin mendimin e tyre për rëndësinë e parqeve arkeologjike dhe diskutojnë se çfarë duhet të kenë parasysh gjatë vizitës në këto parqe.
<p>Vlerësimi i nxënësit/et</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; ▪ për pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor.

6. Planifikimi ditor

data.....

(Ky mësim mund të zhvillohet në formën e një vizite në muzeun arkeologjik)

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Arkeologjia, restaurimi dhe muzeu.</p>		<p>Situata e të nxënit: Vizitë në muze (në këtë orë mësimi situata e vizitës në muze mund të jetë reale)</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mbi përvojat që kanë në lidhje me vizitat në muze. Ata/ato flasin për muzeun arkeologjik dhe për objektet që ekspozon ky muze.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) <i>Kupton drejt mesazhet, që u adresohet;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</i> (2) <i>zgjdh probleme të ndryshme artistike.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zbulon përvoja dhe profesione që lidhen me artin dhe trashëgiminë kulturore; ▪ ndjek rregullat e etikës gjatë vizitës në muze; ▪ vlerëson rolin edukues dhe komunikues që luan muzeu arkeologjik nëpërmjet koleksionit të veprave dhe objekteve të artit. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ arkeologji, ▪ arkeolog, ▪ restaurim, ▪ restaurator, ▪ muze arkeologjik, ▪ park arkeologjik. 	
<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ teksti i nxënësit/es; ▪ fotografi që ilustrjnë gërmimet arkeologjike, restaurimin e objekteve dhe fotografi nga muzeu arkeologjik. 		<p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <p>Historia. Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia.</p> <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Njohja e kulturave. Mjedisi.</p>	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me shfaqjen e materialeve fotografike nga muzeu. Nxënësit/et orientohen për të diskutuar nëpërmjet pyetjeve: Çfarë dini ju për muzeun? Çfarë lloj muzeu është ky? Si e kuptojmë që është një muze arkeologjik? A keni vizituar ju ndonjë muze? Çfarë objektivsh ruan dhe ekspozon një muze arkeologjik? Cili profesion merret me zbulimin e objekteve arkeologjike? Po me ruajtjen e tyre?</p>
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësimi vijon me fotografi që tregojnë mbi gërmimet arkeologjike dhe arkeologët në momentin e punës. Nxënësit/et nxiten të vëzhgojnë me vëmendje fotot dhe u shpjegohet roli i shkencës së arkeologjisë dhe të arkeologut. Mësuesi/ja shpjegon që objektet shpesh gjenden të dëmtuara ose kanë nevojë për përkujdesje dhe pyet nxënësit/et nëse kanë ngjitur ndonjëherë vazo të thyer dhe si. Ai/ajo shfaq fotografinë e një restauruesi që ngjitet një objekt. Kjo është pikërisht puna e restauruesit.</p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon me diskutimet mbi muzeun, mbi rëndësinë e tij edukative dhe mbi mënyrën e ekspozimit të objekteve për të komunikuar më mirë me vizitorët. Më pas mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të flasin për rregullat që duhen ndjekur gjatë vizitës në muze, duke u nisur nga përvojat e tyre. Ai/ajo i orienton nxënësit/et me rregullat më të rëndësishme që duhen ndjekur gjatë vizitës në muze dhe u jep informacion për muzetë arkeologjike që ndodhen në vendin tonë.</p>
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Në fund të orës së mësimi nxënësit/et:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ flasin për muzeun arkeologjik, objektet që ekspozohen dhe mënyrën e ekspozimit; ▪ diskutojnë dhe vlerësojnë profesionet e arkeologut dhe të restauratorit; ▪ shprehin mendimin e tyre mbi rolin edukues të muzeut dhe çfarë duhet të kenë parasysh gjatë vizitës në muze.
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësimi do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re. ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor.

7. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Projekt: Dokumentimi i objekteve arkeologjike.</p>		<p>Situata e të nxënit: Të dokumentojmë objektet e arkeologjike si pjesë e çmuar e trashëgimisë tonë kulturore.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mbi detyrën që kanë marrë, atë të dokumentimit të objekteve arkeologjike. Të ndarë në grupe diskutojnë për informacionin që kanë mbledhur mbi objektet e parqeve arkeologjike. Më pas secili/a nxënës/e bën skicimin e objektit dhe vendos të dhënat, duke marrë kështu rolin e dokumentuesit të objekteve të trashëgimisë kulturore.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: (5) <i>Orientohet që të shfrytëzojë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit në art pamor;</i> (3) <i>Shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës pamore.</i></p> <p>Kompetenca e të menduarit: (1) <i>Merr dhe përpunon njohuritë pamore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi për të zgjidhur probleme të ndryshme artistike;</i> (3) <i>Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</i></p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: 1) <i>Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim artistik;</i> (2) <i>Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.</i></p> <p>Kompetenca personale: (1) <i>Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike;</i> (3) <i>Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.</i></p> <p>Kompetenca qytetare: (1) <i>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore</i> (3) <i>Bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</i></p> <p>Kompetenca digjitale: (1) <i>Gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>zbulon përvoja dhe profesione që lidhen me artin dhe trashëgiminë kulturore;</i> ▪ <i>përdor elementet e gjuhës pamore dhe teknikën e vizatimit për të realizuar dokumentimin e objekteve arkeologjike.;</i> ▪ <i>vlerëson rëndësinë e ruajtjes dhe të dokumentimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.</i> 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ trashëgimi kulturore, ▪ objekte arkeologjike dhe muzeale, ▪ dokumentimi i objekteve të trashëgimisë. 	

<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fotografi që tregojnë objekte arkitektonike dhe muzeale arkeologjike nga vendi ynë. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Historia. Teknologjia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Trashëgimia jonë kulturore. Mjedisi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi/ja ka prezantuar temën e projektit dhe i ka dhënë udhëzimet për të një orë me parë. Klasa është ndarë në grupe dhe secili grup ka përzgjedhur një nga parqet arkeologjike. Çdo përfaqësues i grupi prezanton parkun arkeologjik dhe punën paraprake për mbledhjen e materialeve fotografike nga këto parqe. Edhe objektet muzeale bëjnë pjesë në materialet e mbledhura nga çdo grup.</p> <p>Më tej mësuesi/ja orienton nxënësit/et për dokumentimin e objekteve.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon që fotografia është një mënyrë e dokumentimit të këtyre objekteve, por dokumentimi bëhet edhe nëpërmjet skicave e vizatimeve. Ai/ajo orienton kryetarët/et e grupeve të shpërndajnë punën te anëtarët/et e grupit. Çdo anëtar/e ka për detyrë të skicojë një objekt (arkitekturë, skulpturë apo vazo qeramike) të përzgjedhur më parë nga grupi. Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et që pasi të mbarojnë skicën duhet të emërtojnë objektin, prejardhjen dhe përmasat (nëse janë).</p> <p>Gjatë kohës që nxënësit/et punojnë mësuesi/ja monitoron punën e grupeve.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë, kryetarët/et e grupeve paraqesin punën e bërë nga grupi i tyre. Ata/ato shpjegojnë objektet që kanë zgjedhur dhe rëndësinë që këto objekte kanë.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë edhe për rëndësinë që ka dokumentimi i trashëgimisë kulturore. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; ▪ në bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë për punën në grup; ▪ në realizimin e detyrës sipas kërkesave. 	

8. Planifikimi ditor

data.....

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Ekspozita e fundvitit.</p>		<p>Situata e të nxënit: Krijimet tona në ekspozitë.</p> <p>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. Ata/ato diskutojnë për të zgjedhur titullin e ekspozitës së tyre dhe përzgjedhin punët sipas tematikave të ndryshme nën udhëzimet e mësuesit/es.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (4) Është komunikues efektiv.</p> <p>Kompetenca e të menduarit: (2) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese; (3) Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</p> <p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete në artin pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese; (2) Kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; (2) Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike, shkollore dhe në komunitet; (3) Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.</p> <p>Kompetenca qytetare: (1) Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; (2) Respekton punën e vet dhe të të tjerëve; (3) Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <p>zhvillon aftësitë krijuese dhe ndërvepruese;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ komunikon në mënyrë efektive me shokët dhe shoqet e klasës; ▪ përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi gjuhën pamore; ▪ diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës; ▪ shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në krijim. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ekspozitë, ▪ përzgjedhje e punimeve, ▪ vendosje dhe ekspozim. 	

<p>Burimet/ mjetet/ materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijimet e nxënësve/eve të realizuara gjatë vitit shkollor në të gjitha tematikat; ▪ mjete të tilla si: tabakë letre, ngjitës, gërshtë, pineska etj. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Teknologjia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi.</p>
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të krijojnë një ekspozitë me punimet e tyre të krijuara gjatë vitit shkollor. Aty ata/ato do të shfaqin punën dhe ecurinë e tyre në lëndën e artit pamor gjatë vitit shkollor. Fillimisht mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë një titull për ekspozitën dhe i orienton të diskutojnë për mënyrën se si ndërtohet një ekspozitë dhe të tregojnë për përvojat e tyre në ekspozimin e punimeve.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et se për të hapur një ekspozitë të përbashkët, duhet të punojnë në grupe. Mësuesi/ja e ndan klasën në katër grupe dhe i orienton për ndarjen e punës. Një grup së bashku me mësuesin/en do të përzgjedhë punët më të mira për secilën tematikë, në mënyrë që çdo nxënës/e të jetë pjesëmarrës/e i/e barabartë në ekspozitë. Është mirë që të ketë punime nga secila tematikë.</p> <p>Grupi i dytë i ndan punimet sipas tematikave dhe i kalon te grupi i tretë, i cili bën vendosjen e punëve në tabakët e letrës. Grupi i katërt përcakton dhe ndan hapësirat ku do të vendosen punimet dhe si do të vendosen.</p>	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin, diskutojnë për ekspozitën e tyre, për njohuritë që kanë marrë gjatë këtij viti shkollor në lëndën e artit pamor dhe se si i përdorën ato në krijim. Ata/ato diskutojnë për mënyrën e bashkëpunimit dhe rezultatin e ekspozitës. Punime ruhen në portofolin e nxënësit/es.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit/es</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet: në bashkëpunimin dhe në komunikimin me njëri-tjetrin; në diskutimet që ata/ato bëjnë mbi njohuritë e marra në gjuhën pamore; në përdorimin e fjalorit të duhur artistik.</p>	

4.3 Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mësimit në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor etj. Ai/ajo përdor mjete pamore, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit etj dhe duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi/ja përdor fjalë e fjali të qarta të sakta kuptimore dhe një fjalor të pasur të gjuhës artistike pamore. Mësuesi/ja siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve/eve përmbajtjet e caktuara ose shkathtësitë që ata/ato duhet të performojnë.

Mësuesi/ja u krijon mundësi nxënësve/eve që me anë të medieve të demonstrojnë apo prezantojnë detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësuesi/ja duhet të demonstrojë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e artit pamor. Për nxënësit/et e kësaj moshe është shumë e rëndësishme lidhja midis demonstrimit të mësuesit/es dhe dhënies mundësi të përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë ata/ato do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit/es i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme.

Programi i artit pamor u jep të gjithë nxënësve/eve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sere mjetesh dhe teknikash artistike dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit/et në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues.
- Fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore, etj.
- Riprodhime të veprave të artit dhe postera.
- *Mjetet audiovizive si:* TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit/es, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto

burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese.

- *Mjedisi* mësimor: (klasa, kabinetet e artit pamor etj.).

VLERËSIMI

5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.

Vlerësimi tremujor

Vlerësimi periodik tremujor përfshin:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.
- *Vlerësimin me detyrë* përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/es* për periudhën tremujore.

Këto vlerësime shënohen në regjister në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetorepërfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit me detyrë përmbledhëse* të tri periudhaves tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es* të tri periudhave tremujore.

Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit/es	20%

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
 - Përcaktohet nota vjetore e detyrës përmbledhëse (NVP).
 - Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/es (NVP).
 - Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
 - Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh: nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7).
- $(NVV \times 0.4) + (NVP \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota vjetore përfundimtare}$**

Shembull:

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Nota vjetore			Nota vjetore përfundimtare
NVV	NVP	NVP	NVV	NVP	NVP	NVV	NVP	NVP	NVV	NVP	NVP	
8	9	10	9	10	10	8	10	10	8	10	10	

$$(8 \times 0.4) + (10 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 9.2$$

Nota vjetore përfundimtare 9

